



PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS
THE ALBANIAN CHRISTIAN DEMOCRATIC PARTY OF KOSOVA
ALBANISCHE CHRISTLICH-DEMOKRATISCHE PARTEI VON KOSOVA
PARTITO ALBANESE DEMOKRISTIANO DI KOSOVA
LE PARTI ALBANAIS DEMOKRATE-CHRETIEN DE LA KOSOVA

Organ i aktivistëve dhe intelektualëve demokristianë në Vjenë

BULETIN INFORMATIV Nr. 4- mars 2011

del një herë në 3 muaj

shpërndarja: pa pagesë

„Dielli i shqiptarëve lind në perëndim“ (Faik Konica)

DIELLI DEMOKRISTIAN



Shkrime:

Institucioni i familjes
„Djalëria” e Vjenës
Salzburgu-qytet i muzikës
Shamia me lara
Migrimi dhe edukimi
Partitë politike në diasporë?

**Intervista
Esej
Vështrime
Këndi kulturor**



URIME TRE VJETORIN E PAVARËSISË SË KOSOVËS!

FJALA E REDAKSISË

Të nderuar lexues,

Kemi kënaqësinë e veçantë të ju prezentojmë në 21 faqe numrin e katërt të revistës „DIELLI DEMOKRISTIAN", e cila është organ i aktivistëve dhe intelektualëve demokristianë në Vjenë/Austri, botimi i së cilët realizohet nga këshilli redaktues i saj. Në krahasim me numrat e mëparshëm, kësaj radhe kemi sjellur shkrime nga autorë shqiptarë që jetojnë dhe veprojnë jo vetëm në Austri por dhe në Francë, Gjermani, Kosovë dhe Mal të Zi. Pra, harta gjeografike e artikull-shkruesve tanë po zgjerohet. Në këtë kontekst do dëshironim që në të ardhmen të sjellim edhe tema nga vendet tjera, e sidomos nga Zvicra dhe Shqipëria.

Redaksisë sonë po vazhdojnë t'i arrijnë shumë përgëzime për punën e bërë, gjë që na motivon edhe më shumë në rrugën që kemi nisur. Ne vazhdojmë të përcjellim dhe të informojmë për aktivitetet që ndodhin në Austri. Po ashtu jemi në kontakt permanent edhe me zhvillimet politike dhe shoqërore në hapësirat shqiptare, nga ku sjellim opinione të balancuara duke besuar se me përkushtimin tonë të lartë jemi duke i kontribuar promovimit të integriteteve brenda-shqiptare. Sipas premtimit nga numri i kaluar, si risi kësaj radhe kemi sjellur rubrikën: TAKT (Tema AKTuale) ku si temë diskutimi kemi dilemën: -A mendoni se partitë shqiptare duhet të kenë degët e tyre edhe në diasporë?. Poashtu kemi filluar me pjesën OPILEX (OPinioni i LEXuesve) si dhe kemi mbajtur faqen historike dhe këndin e kulturës. Për më tepër, ju mund të na shkruani lidhur me pyetjet, vërejtjet dhe sugjerimet tuaja në adresat e e-mail-it: dielli.demokristian@gmail.com apo dielli-demokristian@hotmail.com të cilave do tu përgjigjemi në numrin e radhës të kësaj reviste, e cila pritet të dalë prapë në qershor të këtij viti.

Projeksionet tona për të ardhmen janë: dizajnimi i web-faqes sonë në internet (www.dielli-demokristian.net), përkthimi i revistës edhe në gjuhët gjermane dhe angleze si dhe publikimi i „DIELLIT DEMOKRISTIAN” edhe në kopje fizike dhe distribuimi i tij pa pagesë. Shpresojmë që në një të ardhme të afërt të identifikojmë edhe përkrahësit potencial dhe konkret të këtyre projekteve.

Këshilli redaktues falënderon të gjithë ata që ndihmuan në botimin e kësaj reviste periodike, e në veçanti ata që dërguan shkrimet e tyre, si dhe mbështetësit tanë moral. Ky numër është përpiluar, dizajnuar dhe botuar në sajë të punës dhe angazhimit vullnetar të aktivistëve tanë pa asnjë kompensim financiar, dhe si i tillë do shpërndahet në adresat elektronike të lexuesve në të katër anët e botës.

Në fund, redaksia ju uron të gjithë shqiptarëve të besimit të krishterë

Për Shumë Mote Pashkët!

Lexim të këndshëm!

Këshilli redaktues:

Kristina Pjetri
Mark Gjuraj
Vilson Kola
Lush Neziri
Mark Marku

Bashkëpunëtorë të jashtëm:

Hazir Mehmeti
Anita Marku
Agron Shala
Shtjefën Daka
Valentina Pjetri
Zef Ndrecaj
Lulzim Bazhdaraj
Daniella Radi
Xhenc Bezhi

“Me gjak jam shqiptare; me nënshtetësi, indiane. Përsa i përket besimit, jam murgeshë katolike. Sipas thirrjes, i përkas botës. Por zemra ime i përket plotësisht Zembrës së Krishtit”.

Nënë Terezës, me shtat imcak, por me besim shkëmbor, të patundur, iu besua misioni të kumtonte dashurinë e etur të Jezusit për njerëzimin, veçanërisht për më të varfërit ndër të varfër. *“Hyji vijon ta dojë botën dhe na dërgon ty e mua për t'u shprehur të varfërvë dashurinë dhe mëshirën e Tij”.* Në shpirtin e saj, përplot me dritën e Krishtit e me dashuri të zjarrtë për Të, kishte një dëshirë të vetme : *“Të shuante etjen e dashurisë së Tij për shpirtrat njerëzore”.*

Nënë Tereza: I desha njerëzit	3
Info nga MKSHA	4
Info nga VALE	5
Institucioni i familjes „Djalëria” e Vjenës	6
Salzburgu – qyteti i muzikës	7
Shamia me lara	8
Reagim	9
Migrimi dhe edukimi i të rinjëve	10
Partite politike në diasporë	11
PSHDK në udhëkryq	12
Intervistë me: Violeta Marniku	13
Fjala jonë	14
Rini-ju jeni ardhmëria e kombit	15
Politizimi i regjistrimit të popullsisë	16
Famullia e Gjakovës	17
Intervistë me: Halil Jasharin	18
Info blic	19
Këndi kulturor	20



Shkruan: Prof. Dr Anton Nikë Berisha

Anton Nikë Berisha lindi më 7 gusht 1946 në katundin Dobërdol, komuna e Klinës, Kosovë. Shkollën normale e mbaroi më 1966 në Prishtinë. Më 1971 mbaroi studimet në Fakultetin filozofik, Dega gjuhë e letërsi shqipe, të Universitetit të Prishtinës, ndërsa më 1976 kreu studimet e rregullta pasuniversitare pranë Fakultetit filozofik të Universitetit të Zagrebit dhe mori titullin e magjistratit të filologjisë. Po në këtë Universitet (më 1981) mbrojti tezën e doktoratës shkencore.

Kumtesa e lexuar në tribunën shkencore, në kuadër të aktiviteteve „Ditët e Nënës Tereze”, mbajtur në fakultetin juridik të Universitetit të Vjenës, me 3 shtator 2010

Nënë Tereza: I desha njerëzit me dashurinë e Hyjit

(vijon nga numri i kaluar: *pjesa e dytë*)

Klithja e Krishtit në kryq “Kam etje” për Nënë ishte dashuria konkrete për tjetrin, ishte mirëkuptimi që secili njeri duhet të ketë për të afërmin; ishte etja për dashuri që e bën shpirtin e njeriut të pasur, njerëzor, hyjnor. Kush ka etje – dashuri për të afërmin – sidomos për të mjerët, ai ka etje – dashuri dhe për Hyjin.

Në Letrën e shkruar në Varanasi (25 mars 1993), që cilësohet si *Testamenti shpirtëror*, Nëna e bëri publike atë që përjetoj duke udhëtuar për Darjeeling të Indisë (rrëzë Himalajeve) më 10 shtator 1946: “*Thirrjen brenda thirrjes*” të Birrit të Hyjit, Krishtit (thirrjen e parën të Tij ajo e përjetoj më 15 gusht 1922 në Kishën e Letnicës në Kosovë). Kjo thirrja e ndryshoi rrjedhën e jetës e të veprimit të Nënës Tereze dhe në vijim të jetës së saj atë e cilësoi një përmasë e dukshme hyjnore. Këtë gjë e theksuan shumë nga njerëzit që bashkëpunuan ose e takuan, të cilët kur ishin në praninë e saj ndiheshin në “*pranë të dritës*” së vetë Hyjit që kishte dhe rrezatonte ajo, për arsye se “Prania e Hyjit në të i jepte Nënës Tereze një lloj energjie rrezatuese” ose “Nuk mund të mendoj ndryshe: para meje ishte dikush, të cilit Zoti ia ka shënuar Parajsën, njëmend dora e Zotit”.

Me dashurinë e jashtëzakonshme që Nëna Tereze dëshmoi ndaj Hyjit dhe ndaj njeriut, veçmas me kujdesin që u kushtoi të varfërve nga më të varfrit, fëmijëve bonjakë e të braktisur, njerëzve që vdisnin buzë rrugëve pa kujdesin e askujt dhe të gërbulurve, ajo dha shembullin konkret si duhet të çmohet secila qenie njerëzore dhe si mund dhe duhet të jetë jeta e njeriun në tokë – një kopsht i ri i Edenit.

Qenësia e veprës dhe e mendimit të Nënës Tereze vazhdon të jetë e pranishme edhe pas ndërrimit të jetës së saj. Këtë e përlligjin dhe këto dy mendime në vijim. Papa Gjon Pali II, një vit pas ndërrimit të jetës së Nënës (më 1998) tha: “*Kujtimi i saj mbetet i gjallë në secilin prej nesh, në gjithë Kishën dhe në tërë botën. Çfarë vepre të mrekullueshme ka ditur ta përmbushë deri në fund kjo grua me shtat të vogël, lindur në një familje të përvuajtur, me forcën e besimit në Zotin e të dashurisë për të afërmin! Nëna Tereze ka qenë një dhuratë e Zotit*

për të varfrit nga më të varfrit e në të njëjtën kohë, (dhuratë) për dashurinë e saj të jashtëzakonshme për më të mjerët... Përkushtimi i saj i tërësishëm Zotit, përlligjur prej ditë në ditë në lutje, u shndërrua në një përkushtim të plotë për të afërmin. Në buzëqeshjen, në gjestet e në fjalët e Nënës Tereze, Jezusi ka ecur nëpër rrugët e botës si Samaritan i mirë, e vazhdon të bëjë në Misionaret e Dashurisë e në Vëllezërit misionarë të Dashurisë, që përbëjnë një familje të madhe të themeluar nga ajo... lutemi për të gjithë këta që të mos ndërpresin t'i rrinë besnikë hirit që Shpirti i Shenjtë pati ngjallur në Themeluesen e tyre”.

Motra, Mary Nirmala Joshi, trashëgimtarja e parë në udhëheqjen e Misionareve të Dashurisë, pesë vjet pas vdekjes së Nënës, tha: “*Dëshmia dhe mesazhi i saj janë bërë të çmueshëm për persona të çdo feje, si shenjë që Zoti edhe sot e do botën. Në pesë vitet e fundit pas vdekjes së saj shumë vetë i janë drejtuar asaj për të kërkuar ndihmë dhe kanë provuar dashurinë e Zotit përmes ndërmjetësimit të saj...Të gjithë të sëmurët, ata që vuajnë dhe gjithë ata që kërkojnë ndihmën e Zotit gjejnë tek Nëna Tereze një mike që ndërmjetëson për ta”.*

Vepra dhe mesazhi i Nënës Tereze është një gurrë e gjallë që rrezaton dritë të vijueshme në shpirtin e secilit që ka etje për jetë dhe dëshiron të thellohet në qenësinë e besimit në Hyjin dhe në fatin e njeriut.

(fund)



Mesha përkujtimore për Don Nikollë Kaçorri



Me 6 shkurt 2011 në Vjenë, nën drejtimin e Don Pren Kolës, udhëheqës i Misionit Katolik Shqiptar në Austri u mbajt mesha përkujtimore kushtuar Don Nikollë Kaçorrit, nëshkruesit të dytë të Deklaratës së Pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912.

Në këtë ngjarje morën mbi 400 pjesë qindra qytetarë, mësues, gazetarë, aktivistë dhe diplomatë, mes tyre edhe Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Vjenë, Dr. Vili Minarolli.

Pas programit artistik në të cilin e recituan vargje me përmbajtje atdhetare, Don Pren Kola solli një historik të shkurtër për jetën dhe veprën e Don Nikollë Kaçorrit, i cili lindi me 1862 në Lurë afër Matit dhe vdiq me 1917 në Vjenë. Përpos meshtar, ai ishte dhe përhapës i librit shqip dhe shtypit patriotik, Don Nikollë Kaçorri mori pjesë dhe në Kongresin e Manastirit me 14 nëntor 1908 ku u vendos Alfabeti i Gjuhës Shqipe. Më 28 nëntor 1912, në mbledhjen e parë të Kuvendit Kombëtar të Vlorës, ku u nënshkrua Deklarata e Pavarësisë së Shqipërisë, Don Nikollë Kaçorri nënshkroi i dyti, pas Ismail Qemajit. Ai ishte Zëvendës-Kryeministër i Qeverisë së Pavarësisë së Shqipërisë..

Në janar të këtij viti, pas plot 94 vjetësh, u gjetën eshtrat e Don Nikollë Kaçorrit në Vjenë. Ky projekt kishte përkrahjen edhe të qeverisë austriake. Me 9 shkurt 2011 mbetjet e tij mortore u kthyen në Shqipëri, ndërsa u varros me 13 shkurt 2011 në Durrës në prani edhe të Kryeministrit të Shqipërisë Dr. Sali Berishës dhe Kryetares së Parlamentit Jozefina Topallit.



Mesha e Paqes për nder të tre-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës

Me 20 shkurt 2011 në Vjenë u mbajt mesha për paqe, organizuar nga Misioni Katolik Shqiptar në Austri (MKSHA), me rastin e tre-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

Në këtë manifestim morën pjesë një numër i madh i bashkëatdhetarëve, ndër të cilët edhe përfaqësues të shoqatave të ndryshme, partive politike, arsimitarë të mësimit në gjuhën shqipe, gazetarë, aktivistë dhe përfaqësues të institucioneve lokale austriake.



Në adresimin e tij, udhëheqësi i MKSHA, Don Pren Kola, ndër të tjera theksoi se „Shpallja e Pavarësisë së Kosovës ishte shprehje e vullnetit të popullit të saj, dhe se populli shqiptar kultivon me fanatizëm tolerancën fetare, çka e dëshmon edhe pjesëmarrja në këtë meshe e bashkëkombësve nga të tre besimet”. Në meshe u shfaq edhe një program artistik me poezi shqipe, ndërsa i tërë manifestimi u përcoll edhe nga një ekip i RTK-sektori për diasporën.

INFORMATË për bashkatdhetarët tanë në Austri:
Mësimi Plotësues në Gjuhën Shqipe
(Austri 2010-2011)

Të nderuar bashkatdhetarë,

Mësimi Plotësues në gjuhën shqipe është i mundur të mbahet në tërë Austri aty ku ka numër të nxënësve për grupin mësimor.

- Mësimi është i financuar nga shteti austriak;
- Nxënësi vijon mësimin shqip me lejen e prindërve;
- Prindërit kanë të drejtë që nga disa shkolla t'i grupojnë nxënësit në njërën nga shkollat e afërta;
- Nxënësit i shkruhet në dëftesë/apo notohet/ se ka vijuar mësimin.

Të nderuar bashkëkombës,

Njëra nga detyrimet e juaja kombëtare është mësimi i fëmijëve tuaj i gjuhës shqipe. Mësimi bëhet në shkollë. Aty fëmija i juaj do mësojë të lexoj, shkruaj, flasë, këndoj, recitoj e të shoqërohet me fëmijë shqiptar. Ju mund ta ndihmoni shumë në shtëpi duke i folur atij/asaj vetëm shqip, por nuk mund të zëvendësohet në asnjë rast shkolla. Të gjithë pedagogët e shquar botëror e thonë se „*mësimi i gjuhës amtare e ndihmon edhe mësimin në lëndët tjera në gjuhën e shkollës*”.

Ja një porosi informative nga dokumentet zyrtare të Ministrisë së Arsimit të Austrisë drejtuar prindërve në të dy gjuhët:

bm:bwk **gjermanisht**

„...die Teilnahme an diesem Unterricht ist freiwillig und kostenlos, doch wird empfohlen, dieses zusätzliche Bildungsangebot für Ihr Kind aufzugreifen. Die im Elternhaus zu Grunde gelegten Kenntnisse in der Muttersprache können damit gefestigt und verbessert werden. Gute Kenntnisse in der Muttersprache, können sich auf die Leistungen in Deutsch und in anderen Unterrichtsgegenständen positiv auswirken”.

Shqip

„... Pjesëmarrja në këtë mësim është vullnetare dhe falas, por shfrytëzimi i kësaj oferte shtesë për përgatitjen e fëmijës tuaj është i këshillueshëm. Njohuritë e gjuhës amtare që themelohen në rrethin familjar mund të forcohen dhe të përmirësohen. Njohuri të mira të gjuhës amtare mund të ndikojnë pozitivisht edhe në performancat në gjuhën gjermane dhe në lëndë të tjera mësimi”.

Të nderuar prindër!

Mësimi Plotësues Shqip mbahet sipas plan-programeve nga Ministrinë e Arsimit të Kosovës e Shqipërisë. Lëndët që mësohet janë: gjuhë e letërsi shqipe, histori, gjeografi, edukatë muzikore, edukatë arti, etj. Të gjitha këto me bazë nga të gjitha trevat shqiptare.

Shumë nga tekstet shkollore janë të siguruara falas nga Ministria e Arsimit të Austrisë dhe Ministria e Arsimit të Kosovës.

Për të gjitha këto mund të informoheni nga mësuesit/et shqiptar/e dhe drejtoritë e shkollave përkatëse.

Mësuesit e prindërit shqiptar e kanë formuar shoqatën e tyre me emrin „VALE”, kryetar i së cilës është mësuesi në Vjenë, z. Osman Ademi.



Shkruan: Daniella Radi, sociologe

Daniella Radi u lind me 4 shkurt 1986 në Gjakovë. Ka përfundur fakultetin filozofik-dega e sociologjisë në Universitetin e Prishtinës. Nga viti 2004-2009 ishte aktive në shoqatën Aksioni i Rinisë Shqiptare „Pjetër Bogdani“. Një kohë ishte e angazhuar edhe nga ana e Këshillit Qendror të Zgjedhjeve të Kosovës.

Institucioni i Familjes

(vijon nga numri i kaluar: pjesa e dytë)

Në kultura të ndryshme, ashtu si për elemente tjera të jetës sociale, edhe familja ka një shumëllojshmëri modelesh. Ndryshimet janë të mëdha lidhur me aspekte të tilla si çfarë konsiderohet familja, lidhjet e saj me njerëz të tjerë të afërm, me kë i lejohet një njëriu të martohet, si bëhet zgjedhja e bashkëshortit, etj. Ne duhet ta krijojmë vetë jetën tone më shumë se njerëzit në të kaluren. Për shembull: krijimi i lidhjeve martesore tani mvaret më shumë nga zgjedhja dhe iniciativa e individit sesa nga ajo që cakton prindi. Kjo përbën një liri më të madhe për individin por përgjegjësia shpesh mund të imponojë stresse e vështirësi.

Familja është një ndër institucionet tejet me rëndësi dhe paraqet formën e veçantë dhe specifike të marrëdhënjeve shoqërore. Ajo në një kuptim qëndron në vetë bazat e shoqërisë ekzekutuese. Familja përbën edhe më shumë se një bërthamë e pastër juridike, shoqërore dhe ekonomike, një bashkësi dashurie dhe solidariteti që është në mënyrë të vetme e përshtatshme për të mësuar dhe për të veçuar vlerat kulturore, etike, shoqërore, shpirtërore dhe fetare, thelbësore për zhvillimin dhe mirëqenien e anëtarëve të vet dhe të shoqërisë.

Familja si grup shoqëror - Familja krijon dhe pasqyron kulturën e caktuar e cila mund të përshkruhet kështu: „Familja është grup kryesor shoqëror e cila në varësi prej zhvillimit historik dhe shoqëror-ekonomik, i bashkon individët e lidhur me jetën bashkëshortore dhe me pasardhësit e tyre, eventualisht edhe qarkun më të gjerë ose më të ngushtë të cilët bashkohen për plotësimin e nevojave të ndryshme (plotësimin e instiktit, të lindjes dhe rritjes së fëmijëve) e të nevojave ekonomike (prodhimtaria, shpenzimet, shkëmbimi), nevojave sociale (mbrojtja e anëtarëve të familjes), nevojave edukative, e motive të tjera“. Familja bashkëshortore mund të përkufizohet kështu: „ Familja bashkëshortore është grupi themelor shoqëror e cila themelohet me martesë, me jetë bashkëshortore në mes të dy personave me gjini të kundërt dhe pos tyre e përbëjnë edhe pasardhësit e tyre (megjithatë prezenca e tyre është e domosdoshme për ekzistencën e familes, ashtu sikurse edhe prania e një prindi), dhe funksionet e së cilës janë: krijimi dhe ngritja e pasardhësve, plotësimi plotësimi i nevojave emotive dhe tjera (edukative, sociale, ekonomike) etj.

Familja si institucioni më i vjetër dhe më i rëndësishëm në të gjitha llojet e shoqërisë përbën njësinë themelore. Përkundër shumë burimeve të cilat ofrojnë të dhëna shqetësuese për shtimin e numrit të shkurorizimeve, mbi numrin gjithnjë më të madh të fëmijëve që lindin jashtë martese, mbi pozitën e ndryshuar të gruas në familjen

bashkohore, mbi stilet alternative të jetesës, familja edhe më tutje mbetet institucion qendror.

Familja sot- në bazë të kulturës dhe civilizimit të përgjithshëm, qëndron mbi familjen e vjeter patriarkale. Ajo është duke përjetuar ndryshime të shumta, kryesisht në konsolidimin në baza të reja shoqërore-ekonomike të progresit dhe të zhvillimit të njerëzve në tërësi. Familja është formë e bashkësisë shoqërore e cila pas lidhjeve bashkëshortore ka edhe funksione të tjera të shumta. Si kategori sociologjike dhe historike-shoqërore ajo është shfaqur dhe zhvilluar historikisht duke ndërruar format në brendinë e vet shoqërore. Familja është, siç shprehet edhe Luis Morgani, „Element aktiv“. Ajo asnjëherë nuk qëndron në vend por evoluon prej formave të ulta në forma të larta në përpjestim me zhvillimin e shoqërisë:- prej shkallës së ultë në shkallë të lartë.

Në shoqërinë e re, me shfaqjen e kushteve të reja materiale, çështja e familjes zë vend tejet me rëndësi sepse kjo shoqëri duke krijuar industrinë, fabrikat etj, dalëngadalë prej familjes e tërheq jo vetëm mashkullin e femren por edhe fëmijët për punë jashtë familjes, me të cilën gjë mundëson krijimin e disa çështjeve dhe problemeve në vetë familjen të cilat janë të natyrës së rëndësishme. Duke analizuar këtë gjendje dhe në lidhje me dukuri të reja, në radhë të parë me shkuarjen e femrës dhe të fëmijëve në punë jashtë familjes, shumë teoricient konstatojnë që mjetet moderne dhe prodhimtaria moderne e mundëson femren të inkuadrohet në punë, në industrinë moderne dhe gruaja mund të punojë edhe në makinat moderne dhe me punën e vet të ekonomizojë dhe prodhojë.

Shpeshherë theksohet se familja sot në tërë botën është duke përjetuar krizë të dukshme. Nuk ka dyshim që themelet, rrënjët e kësaj krize qëndrojnë kryesisht edhe në karakterin e marrëdhënjeve brenda në familjen bashkëkohore ku ato marrëdhënje janë kualitativisht marrëdhënje të reja dhe në kundërshtim me konceptione patriarkale që kanë ekzistuar edhe ekzistojnë akoma në familje.

(vazhdon në numrin e ardhshëm)



Shkruan Hazir Mehmeti, mësues dhe gazetar në Vjenë

Përvjetor: Me rastin e 90-vjetorit të daljes së numrit të parë të revistës “Djalëria”

„Djalëria” e Vjenës, një shkëndijë e pashuar në kulturën tonë
(pjesa e parë)



Vjena, kryeqyteti i Austrisë, luajti një rol me rëndësi në kulturën e shumë popujve që ishin në përbërjen e monarkisë Austriake, por edhe të popujve të tjerë të kontinentit. Shqiptarët, si popull i vogël, por me kulturë të lashtë, ishin gjithherë pikë interesimi e shumë shkencëtarëve evropianë, ku dallohen në veçanti ata nga hapësira gjermano-folëse. Këtu duhet përmendur dokumentin e vjetër me fjalë të shkruara nga shqipja, fjalori i gjermanit, Arnold Von Harfit, para pesë shekujsh, i cili merret si njëri nga burimet e vjetra të gjuhës shqipe. Duke qenë Vjena si qendër e kulturës dhe politikës evropiane, edhe shqiptarët ishin të interesuar për shkollim në universitetet austriake, e veçanërisht në Universitetin e Basho, Raku Buda, Remzi Baçe, Safet Butka, Gjovalin Gjadri, Kristë Maloki e shumë të tjerë. Ata ishin të organizuar kryesisht në shoqërinë „Albania”. Pa e harruar këtu veprimtarinë e Jani Bashos, i cili ishte veprimtar aktiv dhe kryetar i shoqërisë „Albania” dhe kryeredaktor i revistës „Djalëria” në vitet 1921-24. Më vonë Basho pas kthimit në atdhe ishte themeluesi i obstetrikë-gjinekologjisë shqiptare. „Albania” e Vjenës krahas shoqërive simotra nga Bukureshti, Stambolli, Bostoni, Kajro etj do të ketë një rol historik në formësimin e kombit shqiptar dhe aspiratave kombëtare. Kjo shoqëri studentore mblidhte rreth vetes studentët shqiptarë (rreth tridhjetë sish), por edhe atdhetarët e miqtë të tjerë në aktivitetet me rëndësi kombëtare.

Dy vjet pas formimit të shoqërisë studentore „Albania”, në mars të vitit 1920, ajo merr vendim për nxjerrjen e revistës së saj me emrin „Djalëria”, numri i parë i së cilës e sheh dritën në prill të po atij viti, tani e nëntëdhjetë vjet më parë. Adresa e saj ishte: Albania, Univerziat, 1, Wien. Redaktor përgjegjës i së revistës u caktua Nush Bushati, i cili ishte edhe njëri nga themeltarët e shoqërisë studentore. „Djalëria” si revistë kulturore, letrare e shoqërore e ilustruar vijoi të botohet me ndërprerje në 32

Vjenës, si njëri nga më të njohurit jo vetëm në Evropë. Ndjenja e miqësisë e shprehur nga vendoret ndaj kulturës dhe historisë shqiptare bëri që Vjena të jetë një qendër me peshë në historinë tonë dikur dhe në historinë tonë më të re. Këtu gjetën mundësinë e shkollimit dhe veprimt shumë nga intelektualët me zë e peshë në rrjedhat e progresit tonë shoqëror. Kjo lidhet detyrimisht me miqtë vendor që dhanë një ndihmesë të madhe në shumë fusha hulumtuese rreth gjuhës, kulturës dhe etnisë shqiptare.

Njëri nga këta, pa dyshim, është Norbert Jockli, albanolog hebre dhe Franz Nopca, ndër të parët themeltarë të albanologjisë si shkencë, të cilën e vazhduan pastaj nxënësit e Jocklit siç ishin Eqrem Çabej, Aleks Buda etj. Njëri nga veprimtarët pararendës pa dyshim ishte Dr. Gjergj Pekmezi. Me iniciativën e tij në Institutin e Orientalistikës së Vjenës u hap katedra e gjuhës shqipe (viti 1903) njëra nga të parat në Evropë dhe në botë, ku do studiohej gjuha shqipe. Ai ishte edhe nga të parët ligjërues i gjuhës shqipe në Universitetin e Vjenës deri në vitin 1938. Në dhjetëvjetëshit e parë të shekullit të kaluar në Vjenë studionin e vepronin shumë intelektualë shqiptarë, ndër ta figura të njohura të kulturës e shkencës shqiptare, si: Eqrem Çabej, Hil Mosi, Lasgush Poradeci, Aleks Buda, Aleksander Moisiu, Nush Bushati, Fuad Asllani, Jani numra, deri në vitin 1929, duke përhapë dije, informata nga kultura, nga jeta e studentëve në Vjenë.

Pa dyshim revista „Djalëria” u bë tribunë e botimeve të studiuesve shqiptarë, por edhe e të tjerëve. Pas nëntëdhjetë vjetësh, po shkëpusim disa copëza nga numri i parë i shkruar nga grupi i studiuesve themelues të saj, me titull : „Me rastin e lindjes së „Djalërisë” „...Dëshira më e madhe e çdo shqiptari të vërtetë duhet të jetë lumturia e Shqipërisë. Gjithë ajo lumturi është edhe e studentëve shqiptarë. Djalëria shqiptare e sotshme nuk është në gjendjen e këndshme të asaj te kombeve të tjerë dhe nuk e ka trashëguar prej të parëve të saj bashkimin e plotë të kombit të vet, as lirinë e tërë tokave shqiptare. ... Zgjedha e rëndë dhe robëria e gjatë na bënë të mbetemi aq prapa, sa në ditë kritike kur ndahesh fati i kombit tonë nuk u dëftuam të zotet e kohës. Popujt e tjerë fqinjë në kondita të ngjashme, po edhe më të dobët se ne, por të ndihmuar prej fatit, na shkelën e këputën prej trupit të gjallë të kombit tonë pjesë, të cilat edhe sot i mbajnë ndër thonjtë e rëndë”. ...Gjuha shqipe është gjaku i trupit shqiptar; sa më e begatshme, sa më e përparuar ajo, aq më i fortë e më i gjallë trupi shqiptar”.

(vazhdon në numrin e ardhshëm)



Shkruan: Xhenc Bezhi

Salzburgu – qyteti i muzikës *(pjesa e parë)*



Rrallë herë mund të gjendet një vend si Salzburgu ku harmonia në mes peizazhit dhe arkitekturës, artit dhe kulturës, traditës së hershme dhe modernes të jenë aq të përsosura. Qyteti i Muzikës, i njohun në botë për traditën e veprimtarive të tij të papërsëritshme edhe si “The Sound Music” të shtangë që në pamjen e parë: -Manastiret, Fortesat dhe

Kapuzinerberg në njanën anë, dhe pjesa tjetër, matanë lumit Salzach , ku gërshetohen mrekullisht antikja dhe modernja. Salzburgu asht një qytet relativisht i vogël, vetëm prej rreth 150 000 banorësh, por ku mbahen ma shumë se 4 000 ngjarje kulturore në vit. Jemi në kufijtë e fantazisë, pse këtu jeta e qytetit, forca e zhvillimi i tij varen e mbështetën pikërisht tek kjo lloj veprimtarie, pra tek “The Sound Music”. Salzburgu ka luejtë një rol të randësishëm administrativ qysh në kohët romake, si nyje e randësishme e lidhjes veri-jug. Ai asht themelue aty nga fundi i shekulli t të 7-të. Deri në fillim të shekullit të XIX qyteti qeverisej nga kryepeshkopët katolikë.

Pasunia dhe begatia e trashëgueme janë rezultat i tregtisë së kripës ndër shekuj. Me të ardhurat e mëdha që fitonin tregtarët vendosën të ndërtonin një qytetet që i dhanë emnin Salzburg e që vjen prej: Salz=kripë dhe Burg=kështjellë, e që quhej edhe “Roma e Veriut” për bukuritë e tij arkitekturore. Pra asht kripa që i ka dhanë emnin qytetit. Po emni i këtij qyteti asht i lidhun pazgjidhshmënisht me emnin e birit të tij ma të shquem, Wolfgang Amadeus Mozart, që leu në Getreidegasse të Salzburgut me 27 janar 1756. Ai asht magjia që tërheq e vazhdon të tërheqë adhuruesit e muzikës nga e gjithë bota. Shtëpia e tij thuhet se asht një nga objektet ma të fotografueme në botë.

Mozarti, me 350 veprat e tij muzikore nga ma të shkëlqyeshmet që ka njohë njerëzimi, asht ndër muzikantët ma të mëdhej të të gjitha kohave e rrin përkrah Bethhovenit. Ai hapi një kapitull të ri në muzikë në përgjithësi e në atë klasike në veçanti. Bukuritë natyrore, arkitektura, historia, arti, banë që UNESCO ta përfshinte qytetin e vjetër të Salzburgut në listën e trashëgimisë kulturore botënore me mbrojtje të veçantë. “Atmosferën e Salzburgut e rrisin bukuria, lojnat dhe arti ...”, thonte Max Reinhardt, drejtor



historik i Teatri dhe nismëtari kryesor i Festivalit të Salzburgut.

Më 1920, menjëherë mbas Luftës së Parë Botërore, po Max Reinhardt, së bashku me artistë të tjerë dhe intelektualët ma të shquem të Salzburgut realizuen andërrën e tyre tue e shëndrrue qytetin në një skenë të përhershme e mbarë botënore. Me themelimin e Festivalit të Salzburgut, qyteti u ndërkombëtarizue, traditë që jo vetëm vazhdon edhe sot, po ka arrijtë nivelet

ma të paimagjinueshme të organizmit të veprimtarisë artistike. “Njeri i zakonshëm”, apo “Jedermann”, asht pjesa e Festivalit të parë – një pjesë e përhershme e festivaleve muzikore sot e kësaj dite, ndoshta ma prestigjiozi në Evropë. Dirigjenti me famë botënore Herbert von Karajan, le me 5 Prill 1908 në Salzburg ,me 1967 themeloi festivalin e Pashkëve, dhe në vitin 1973



Festivalin e Kreshmëve. Vit për vit, me mija artdashës nga e gjithë bota, në të katër stinët, vizitojnë dhe çmojnë nalt vlerën e këtij festivali.

Nalt, mbi qytet, në mal, ngrihet Kështjella “Hohensalzburg”, selia e dikurshme qeverisëse e Kryepeshkopëve. Ngado të hedhish shikimin, të dalin përpara vende e rrëfime që lidhen me jetën dhe veprimtarinë e Mozartit. Salla e Festivalit asht ma e madhja në Qarkun e Salzburgut. Këtu gjendet shtëpia e Mozartit si dhe shtëpi të tjera të ndërtueme në mesjetë. Rrugicat me kalldrëm, deri tek rrugica e famëshme Getraidegasse, e prej aty tek Manastiri i Shën Pjetrit, janë pjesa ma tipike.

(vijon në numrin e ardhshëm)



Shamia me lara

Debati për shaminë është një debat i shpifur dhe i stisur. Shoqërisë kosovare i duhet shteti laik i zhvilluar ekonomikisht dhe ruajtja e kohezionit fetar të gjitha besimeve. Të gjitha debatet tjera dhe intencat për keqpërdorim të fesë në emër të politikës dhe ideologjive është hedhje e gurëve vetvetes. Këtë nuk e duron Kosova që dikur burrat e dheut e thirrshin nanë. Më i mirë është romantizmi se sa ideologjia fetare apo jo...

Parahistori...

Beogradi zyrtar i mbretërisë edhe në epokën e komunizmit thoshte për shqiptarët se janë një popull anakronik, i pakulturuar dhe i pagdhundur që jeton në injorancë të thellë, gratë i mbulojnë me shami, jetojnë të izoluar larg realitetit andaj si konstatim „akademik“ dilte përfundimi se janë të denjë për t'i shfarosur „nga viset historike serbe“ ose për t'i dëbuar për në Turqi me marrëveshje xhentelme. Përtej konstatimeve të stisura të nacionalistëve serbë, Mitrush Kuteli në „Poem kosovar“ do të kllithte „jam shqiptar-zot e krenar, mbi këtë dhe që e kam si fe e përmbi fe“... Në mes të këtij turbullimi debati i sotëm për shaminë është tragjedi moderne në viset shqiptare. Arsyetimet se përse femra shqiptare duhet të mbajë shami nëpër institucione nuk i duron letra dhe nuk ka kalem poetik që i përthekon. Shamia nuk është ligj dhe domosdoshmëri. Në të kundërt një fije e hollë e ndan shaminë nga përdorimi ideologjik për një shtet islam politik që nuk është aspiratë historike e shqiptarëve dhe as e kohës së sotme. Nëse hedhim një shikim nga bjeshka, mbi format e përdorura dhe mënyrën e krijimit të shtetit do të shohim se Kosova si shtet është themeluar me gjakun e bijve më të mirë nën idenë e shqiptarizmit të shqiptarëve të besimit islam dhe katolik, larg ideve për dominim të kryqit dhe shamisë... Kësaj mund t'i shtojmë mijëra faqe të tjera se shteti i Kosovës është konstrukt perëndimor që nuk duron ide të maskuara nën velon e ideologjive fetare ekstreme...

Shamia me lara....

Kërkesa për institucionalizimin e shamisë është absurd i thellë. Mund të duket e rëndë dhe radikale por regjime të tipit të Ahmadinexhadit thonë se femra duhet të jetë e mbuluar me shami nga koka te këmbët, me një pjesë në formë të sitës tek syte. Kohëve të fundit po themelohen banka ku shërbime mund të marrin vetëm femrat, dhe po varen në litar apo po mbyten me gurë femrat për tradhti bashkshortore reale apo të supozuar. Në thelb të këtij regjimi dhe regjime të tjera të maskuara nën vellon e ideologjive fetare për një islam të inepretuar jo sipas kuranit por sipas qejfit të liderëve autokratë në Arabi është padyshim shamia. Pra, në fokus të diskutimeve dhe heroizmave të këtyre liderëve, që notojnë në naftë dhe injorancë, është shamia-jo shamia e thjeshtë por shamia me lara pasi interpretimi i mëvonshëm del se shamia ka shumë varianta të shpjegimit në thelb të saj për të minuar idetë progresive të një shoqërie të hapur dhe sekulare, për të ndërtuar një shtet fetar nën injorancën dhe padrejtësinë në shoqëri si prelud të fundit në funksionimin e shtetit.

Kosova si model...

Është befasuese injoranca dhe tendenca e debatit për shaminë në një Kosovë pro-perëndimore që duhet thënë se në periudhën e pasluftës „ju kanë përzier lakrat“. Ka një tendencë të qartë për të ndryshuar islamit autokton në këto hapësira që buron nga periudha osmane me një islam tjetër që i vjen era radikalizëm dhe islam politik antiperëndimor, në thelb të cilit janë mjekrrat, pantollonat e shkurtër gati deri në gjunjë dhe shamia si modë përfundimtare për ta fundosur shtetin laik dhe sekular të Kosovës... Kjo ide e rrezikon në substancë kohezionin fetar të shqiptarëve që gjithandaj thuhet se është model për tu afmiruar, por akoma më rëndë, e rrezikon modelin e shtetit të Kosovës si shtet laik dhe sekular i themeluar për të respektuar vlerat njerëzore dhe garantimit me kushtetutë të respektit të ndërsjellë fetar larg radikalizmit dhe injorancës.

Interpretimi fetar i fakteve nuk na parathotë asgjë përse do të duhet ta bëjë një mysliman ideal një njeri-qenje njerëzore me pantollona të shkurtër, mjekërr apo një femër me shami para një myslimani të devotshëm që respekton traditën fetare të tij, lutet në xhami, respekton të tjerët, nuk ndjenjë urrejtje, e njeft religjionin e tij për religjion dhe nuk e sheh në asnjë mënyrë si ideologji para shqiptarisë. Nuk mund të gënjejmë vetveten me përralla dimri. Interpretimi i islamit që në qendër të vëmendjes ka pantollonat e shkurtëra dhe shaminë nuk është interpretim kombëtar shqiptar. Është interpretim i gabuar i tërë historisë së hapësirave shqiptare për themelimin e një shteti religjioz dhe të mbyllur në guaskën e vet të injorancës. Kjo nuk duhet lejuar të ndodhë në asnjë mënyrë. Përgjegjësia e shtetit dhe institucioneve është të respektojnë kushtetutën dhe modelin e një shteti laik dhe modern...

Referendumi...

Interpretuesit e flaktë se Kosova duhet të „shamioizohet“ e me këtë të talibanizohet thonë se çështja e shamisë duhet dërguar në referendum. Është kjo një ide e kalkular, duke menduar se shumica e shqiptarëve i takojnë besimit islam dhe, sipas logjikës, duhet të gëlltisnin këtë „fore“ që të votojnë për një ideologji vrasëse në trojet shqiptare. E para:-referendumi i tillë që bie

ndesh me kushtetutën dhe mënyrën e organizimit të shtetit të Kosovës nuk bën të lejohet të ndodhë. E dyta:-personalisht duke besuar thellë në shpirtin e shqiptarizms që na ka karakterizuar në shekuj nuk besoj se edhe po të lejohej ky referendum do të kishte sukses. Kështu që kjo i bie të jetë një „zar” i humbur në luftë me vetveten e tepruar...

Kohezioni fetar...

Ajo që quhet botë shqiptare nëpër shekuj është karakterizuar për një kohezion fetar të pasqorë, për luftëra në shërbim të kombit të bëra në bashkpunim të plotë nga shqiptarët e të gjitha besimeve. Traktati dhe manifesti politik për shtetin shqiptar nëpër histori është shkruar me gjak dhe lotë nga shqiptarët e të gjitha besimeve. Asnjë ideologji e vonshme me këtë shkallë arsimimi dhe emancipimi gjithandej kufinjve të shkrirë të botës shqiptare nuk mund ta lëkund këtë besim shekullor. Por duhet thënë me zë se na duhet organizim i shpejtë dhe i pasqorë që të mos lejojmë keqinterpretimin e historisë në shërbim të ideologjisë për të mbrojtur idetë shtetërore që bazën e kanë në një shtet modern që respekton të gjitha fetë dhe nuk lejon pantollona të shkurtër dhe shami si ide dominuese mbi këtë dhe që i thonë Shqipëri do të thonin rilindasit. Më i mirë është romantizmi se sa ideologjia fetare apo jo...

Reagim i Kryesisë së Bashkësisë së Degëve të Partisë Shqiptare Demokristiane të Kosovës në Gjermani

Ndajmë dhimbjen me familjet amerikane

Kryesia e B.D. të PSHDK në Gjermani është e tronditur me lajmin për vrasjen e dy ushtarëve amerikanë dhe plagosjen e dy të tjerëve në Frankfurt të Gjermanisë me 2 mars 2011 nga Ardi Uka. Ne ndajmë ngushëllimet më të thella me popullin mik amerikan, ushtrinë amerikane dhe autoritetet amerikane, si dhe me familjet e të vrarëve për këtë humbje të jetës së më të dashurve të tyre, si dhe e dënojmë ashpër këtë akt. Të sulmosh ushtarët e një vendi mik që ndihmuan në çlirimin e Kosovës, përpos që është një vepër makabre e terroriste, është dhe një akt kundër Kosovës e popullit të saj, si dhe kundër interesave të popullit shqiptar. Kryesia e B.D. të PSHDK në Gjermani shpreh mirënjohje të thellë për shtetin e popullin amerikan për kontributin e dhënë për Kosovën dhe vlerat demokratike. Me besimin se dy popujt do të gjejnë forcë e arsye në tejkalimin e kësaj tragjedie, jemi të bindur se ky rast i rëndë dhe i turpshëm i krimit do të mbetet rast i izoluar dhe i pa-përsëritshëm në mes dy popujve tanë miq. Është ardhur koha që ne shqiptarët për këto raste që jo vetëm të deklarohejmë publikisht se i dënojmë, por dhe të punojmë me gjithë fuqinë dhe dijen që kemi, si në diasporë ashtu dhe në Kosovë, që t'i parandalojmë dhe pengojmë rastet e tilla që në zanafillë, duke luftuar me të gjitha mjetet grupet ekstremiste që fatkeqësisht sot nuk janë të pakta në Kosovë dhe që po mundohen që vendin ta orientojnë drejtë shkrepave të Azisë. Kohëve të fundit elementet e këtyre grupeve kanë zënë edhe poste ministrash në qeverinë e re, siq është rasti me Ministrin e Kulturës, Memli Krasniqi, i cili ende pa e marrë si duhet detyrën e Ministrisë jep urdhër që nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të hiqen dy fotografitë e ikonave Shqiptare: Nënës Tereze (Agnesë Gonxhe Bojaxhiut) dhe Presidentit Historik të Kosovës dr. Ibrahim Rugovës. Ndërsa në anën tjetër Hashim Thaçi tradhton marrëveshjen me PSHDK duke mos plotësuar asnjërin kusht të kësaj marrëveshjeje që vetë e kishte nënshkruar, me ç'rast vijmë në përfundim që ai vetë ka rënë pre e këtyre lëvizjeve.

Luz Thaçi, kryetar i B.D të PSHDK në Gjermani

4 mars 2011



Shkruan: Kristina Pjetri, studente në shkallën e tretë-master në Universitetin e Vjenës

Migrimi dhe Edukimi i të rinjve tanë në Evropë

Ne si shqiptarë kemi vlerat dhe traditat tona të cilat dallohen shumë nga të huajt. Për shumicën e të rinjve të cilët ia mësyjnë perëndimit, institucionet perëndimore më së shumti të frekuentuara dhe ato me të cilat ata kanë përvojën më të përafërt janë ato edukative. Prandaj është tejet me rëndësi që të kemi një kuptim më të thellë të rolit dhe domethënies së edukimit dhe institucioneve edukative në perëndimin modern, si dhe të rrënjëve historike të edukimit perëndimor.

Gjithmonë është thënë se rinia është ardhmëria e një shoqërie, e një populli, e një shteti dhe në duart e tyre do të barten përgjegjësitë dhe obligimet për të udhëhequr, edukuar, zhvilluar dhe për të çuar përpara bashkësinë njerëzore. Edhe në perëndim edukimi gjithmonë ka qenë kryesor ngase përmes tij gjenerata e re edukohet që të bartë dhe të avancojë idealet, normat dhe principet e një shoqërie.

Vendosja e të rinjve tanë nëpër metropolet evropiane ishte e përcjellur me sfida të reja dhe të paparashikueshme. Ata deri me pasjen e kontaktit të parë me „botën e parajsës” për të kryesisht kishin përfytyrim tjetër. Ky fakt na detyron të themi se fati i shumë të rinjve shqiptarë ishte dhe është i lidhur ngushtë me aftësinë e tejkalimit të sfidave në realitetin e ri. Pra, motivet të cilat nxitën rininë shqiptare për të migruar nëpër vendet të ndryshme të Evropës janë të shumta dhe nga më të ndryshmet. Shumica e të rinjve shqiptarë dëshironin ta braktisnin atdheun e tyre sepse nuk shihnin ndonjë perspektivë të ndritshme aty.

Edhe përkundër shumë sfidave të kohës dhe të fatit të rinisë shqiptare në diasporë, një pjesë e kësaj rinie po bën përpjekje të mos përfshihet brenda këtyre kornizave të së keqes, mirëpo kërkojnë rrugë të tjera të integritit dhe të ndërtimit të së ardhmes së tyre. Pa dyshim, dihet mirëfilli se fillimi është jashtëzakonisht shumë i vështirë, i përcjellur sidomos me ndjenjat e inferioritetit. Mirëpo një pjesë të kësaj rinie, të nxitur nga ndjenjat tjera të shëndosha, entuziazmi dhe dëshira për të ngarendur drejt një perspektive më të mirë po i mposht vështirësitë.

Është fakt i vërtetë se integrimi i rinisë së diasporës sonë ishte dhe është shumë i vështirë. Njëra nga arsyt tjera është se të rinjtë tanë kishin mërguar gjithnjë me shpresën se shpejt do të ktheheshin në vendlindjet e tyre, pa menduar fare për integrim në shoqëritë e reja. Ishte një kohë euforike kur mendohej se rinia shqiptare dëshironte të kthehej në Kosovë. Sot e vërejmë se ajo eufori ka rënë apo dhe se është shëndërruar në një iluzion. Sidoqoftë, tani një pjesë e të rinjve shqiptarë, të nxitur nga ndjenja e dashurisë ndaj atdheut të tyre dhe duke dashur që të mos „shkëputen” përfundimisht nga vendlindja kanë gjetur format e tyre të veprimit dhe të integritit në kuadër të shoqatave dhe shoqërive të ndryshme integruese. Kjo ndjenjë e integritit të tyre ka një rëndësi dhe rol të madh. Edhe inkuadrimi i të rinjve shqiptarë nëpër aktivitete të ndryshme kulturo-sportive, shoqërore e të tjera janë një element tjetër për takime, përafrime, bashkime e bashkëpunime të rinjve shqiptarë në diasporë. Një pjesë tjetër e të rinjve shqiptarë është shndërruar në një „simbiozë” shqiptaro-evropiane. Pjesa dërmuese e këtyre të rinjve të cilët kanë rënë nën këto kurthe i janë „adaptuar” atyre realiteteve të cilat i kanë mbërthyer. Ata sot më lehtë flasin gjuhët huaja, pra të mjedisit ku jetojnë dhe veprojnë se sa flasin gjuhën shqipe-gjuhën e tyre amtare. Dhe, ky „dualizëm” mund të ngërthejë brenda vetes elemente pozitive, mirëpo ato negative sikur janë më të ndjeshme dhe më të shumta. Këtu paraqet moment të ndjeshëm dhe të rrezikshëm humbja e identitetit kombëtar që në diasporë ka filluar të jetë mjaft e theksuar dhe se po merr përmasa shqetësuese.

Prindërit si institucioni i parë në edukimin e fëmijës bartin përgjegjësinë më të madhe në orientimin e drejtë të fëmijëve të tyre. Nëse fëmijës nuk i jepet edukata e drejtë në vitet e para të fëmijërisë, ai në moshën madhore do të jetë i çorientuar, dhe për të fajtorë do të jenë edukatorët e tij të parë. Këtu nuk nënkuptojmë vetëm edukatën familjare, po edhe atë shpirtërore e cila është edhe esenciale për një zhvillim stabil dhe të drejtë të njeriut, e që mjerisht, në mesin tonë i kushtohet shumë pak rëndësi.

Nëse rinia jonë nuk është e shëndoshë atëherë si mund të presim një të ardhme të mirë. Nëse ajo zhvishet nga ndjenja shpirtërore dhe identiteti kombëtar, atëherë si mund të presim një të ardhme të dëshiruar për shoqërinë tonë? Rinia shqiptare ka një potencial të madh i cili duhet shfrytëzuar. Por duket se e ardhmja e identitetit shqiptar në diasporë është në një rën nga udhëkryqet më të mëdha në historinë e kombit tonë. As sa rinia është e ardhmja e te sotmes ajo është edhe aktualja e të nesërmes...

TAKT (Tema AKTuale)



Shkruan: Mark Gjuraç

Mark Gjuraç u lind me 23 mars 1972 në fshatin Trakaniq, komuna e Gjakovës. Pas përfundimit të shkollës së mesme u angazhua me shumë sukses në sektorin e gastronomisë. Një kohë të gjatë ishte aktiv në Shoqatën Humanitare Bëmirëse „Nëna Tereze“ ku veprroi me përkushtim në të mirë të çështjes kombëtare, duke u maltretuar kështu disa herë nga okupatori serb. Ai ka marrë pjesë në kuvendin themelues për formimin e degës së PSHDK në Vjenë, me 10 maj 2009 me ç'rast është zgjedhur edhe sekretar i saj, funksion ky të cilin e mban ende. Në të njëjtën kohë është angazhuar duke i privë procesit për formimin e degës më e re të PSHDK në Austri, pikërisht në qytetin Wiener Neustadt, ku dhe jeton me familje.

Në diasporë (nuk) duhet të ketë degë të partive politike shqiptare!?

Prolog

Që nga paslufta në Kosovë është hapur debati nëse degët e partive politike janë të nevojshme edhe jashtë shteteve amë. Në këtë shkrim unë do të përpiqem që të sjell para lexuesve përparësitë dhe dobësitë e një organizimi të tillë. Për më tepër, duhet ditur se në disa shtete ka dhe Ministri për Diasporën e poashtu edhe disa vende të rezervuara në Parlament për përfaqësuesit e saj (p.sh: Kroaci). Në Kosovë që vitit 2001 është i mundur edhe votimi përmes postës, gjë që mundëson ndikim direkt në zhvillimin e demokracisë në vendin tonë. Por, për fat të keq, një pjesë e „intelektualëve“ tanë jashtë vendit vazhdojnë t'i permbahen parimit „mos thuaj dhe mos bëj asgjë. Hesht dhe do të marrin për filozof“.

Pro-argumentet

Secili që ka pasur rastin që për një kohë më të gjatë të qëndrojë në perëndim ka vërejtur se mes bashkëatdhetarëve tanë mungojnë shkëmbimet e informacioneve, komunikimi dhe solidariteti ashtu siq ai ishte në vitet kur diaspora jonë kishte rolin kryesor në mbijetesën e Kosovës dhe mbledhjen e fondeve të nevojshme për luftën për liri. Në këtë aspekt, roli i partive politike të atëhershme ishte shumë i rëndësishëm. Për nga nocioni, partitë politike janë struktura të organizuar të cilat kanë një aftësi për të mobilizuar masat, për të mbajtur të ndezur zjarrin e dashurisë për komb dhe atdhe, si dhe janë ura lidhëse mes vendlindjes dhe shteteve ku jemi vendosur tani. Për më tepër ato kanë një traditë të organizimit, strukturat e brendshme, hierarkinë udhëheqëse si dhe kontribuesit e tyre financiar në baza vullnetare. Ato kanë stemat dhe llogot partiake dhe janë të vetmet që kanë bazat e tyre edhe në Kosovë. Kjo filozofi e mendimit nënvizon se për sa i përket shoqërisë civile, në Austri është i madh numri i shoqatave shqiptare, por pothuajse asnjë prej tyre nuk ka një adresë, zyre, web-faqe apo e-mail. Pra, nuk është shumë e qartë se kë përfaqësojnë ata. Në shumicën e rasteve kemi të bëjmë me „One man show“ („shoqatë me vetëm një anëtar-kryetarin“).

Kundër-argumentet

Një pjesë e njezërve tanë në perëndim, sidomos studentët e rinjë janë të bindur se të merresh me organizime partiake në perëndim është diçka e panevojshme. Ca të tjerë mendojnë se ato ndajnë dhe përqajnë më shumë sa sa bashkojnë diasporën shqiptare. Në të njëjtën kohë, mbrojtësit e kësaj teorie mendojnë se barrën e organizimit të shqiptarëve jashtë vendit duhet marrë shoqatat e ndryshme të cilat janë struktura apartiake dhe apolitike. Ato mundën më lehtë se të tjerët

të aplikojnë për projekte, sigurojnë bursa për studentë, sjellin persona për shërim si dhe të promovojnë sportin, kulturën dhe muzikën tonë. Kohëve të fundit është evident edhe fenomeni i regjistrimit të shoqërive fetare në shoqata. Përpos frymës nacionale, ato me vete sjellin edhe humanizmin, solidaritetin dhe mbledhjen e ndihmave për bashkëatdhetarët në nevojë, çka nuk mund të thuhet se është në misionin e partive politike. Nje argument shpesh është dhe fakti se numri i vogël i votave që në Kosovë shkon nga diaspora tregon se njerëzit tanë nuk duan të merren me politikë që bëhet „poshtë“, dhe se nëse po ajo pjesëmarrje politike duhet bërë vetëm në kuadër të partive vendase, në këtë rast në Austri, p.sh: duke u antarësuar në ÖVP, SPÖ, Die Grünen, etj.

Epilog

Dihet se për të pasur një zë në politikën austriake së pari duhet poseduar shtetësinë e këtij vendi. Poashtu është e njohur se të huajt në Austri kanë hapësirë të limituar për të ndikuar në përmirësimin e gjendjes së bashkëqytetarëve të tyre. Në të njëjtën kohë, një pjesë e ish-liderëve të shoqatave janë shpenzuar intelektualisht deri në atë masë sa që shumë pak njerëz besojnë se ata mund të bëjnë diçka më shumë se 2-3 koncerte gjysëm „tallava“ në vit. Nëse në fund të fundit tentohet të veprohet vetëm si individ është vështirë e mundur që sukseset të kenë përmasa aq të mëdha sa do të kishin nëse ato veprimtari do përkraheshin nga grupet e organizuara mbrenda komunitetit. Megjithatë, shumë prej këtyre „intelektualëve të pavarur“ u japin më shumë rëndësi gotave se sa verës. Si konkluzion, unë nuk do marr të drejtën të deklaroj se cilin opsion do e sygjeroja për lexuesit. Unë ka kohë që kam vendosur se ku dhe si do angazhohem. Por, le të mbetet në lirinë e secilit individ që të vendos për veten e tij apo saj. Gjërat më të mira në jetë janë pa pagesë. Në mesin e tyre janë dhe angazhimet në bazë vullnetare për të mirën e komunitetit që i përkasim. E ato zhvillohen kryesisht jashtë katër mureve të banesave tona. Zhvillimi i njeriut dhe shoqërisë bëhet duke vendosur dhe kultivuar kontakte me të tjerët e jo në vet-izolim dhe ikje nga e tërë bota, duke u „enklavizuar“ pa na ndjekur njeri. Gjërat e mëdha fillojnë me hapa të vegjël.

Mos prisni të ju thërrasin, por trokitni!.



Shkruan: Prof. Mhill Shala

PSHDK në udhëkryq

Të nderuar miq dhe dashamirë të fjalës së shkruar në shtetin dhe qytetin me një kulturë të lashtë evropane:-në Austrinë e madhe dhe Vjenë si qendër të civilizimit evropan. E ndjej veten të privilegjuar që mund tu drejtohem me një shkrim të tillë, duke përkujtuar kështu njëzet vjetorin e themelimit të partisë së parë në Kosovën demokratike.



Kjo parti e pagëzuar me emrin Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës-PSHDK është identiteti dhe historia dy mijë vjeqare e këtyre trojeve të lashta arbërore dhe popullit më të lashtë të Ballkanit. Në viset e ILIRIKUMIT kaloi duke përhapur idenë dhe kulturën kristiane të cilën e përqaftuan të parët tanë dhe e nderuan Shën Palin, apostullin e krishterimit. Edhe me këtë vlerë matet dhe përcaktohet historia e kësaj partie dhe si e tillë do të jetë për njerëzimin e këtyre trojeve..

Ideja për formimin e një partie të tillë ishte e Lazër Krasniqit, atëherë drejtor i përgjithshëm i ndërmarrjes së madhe „Elektokosova“, si dhe e Gjergj Rrapit, ish-profesor në Univerzitetin e Prishtinës dhe Umberto Bytyqit, ekonomist. Këta të tre me datën 19 shtator 1990 vizituan bashkësinë lokale të Bishtazhinit, komuna e Gjakovës, ku u takuan me një grup aktivistësh, emrat e të cilëve për hir të modestisë do t'i publikojmë një herë tjetër. Pra, ideja e lartpërmendur e mori „bekimin e parë“ mu në Bishtazhin.

Të hënen, me 8 tetor 1990, në orën 13:00 në lokalet e korit COLEGIUM CANTORUM në Prishtinë, në prezencën e Ekrem Kryeziut, Shkelzen Maliqit, Ilir Hoxhës, Isuf Berishës, Mark Krasniqit dhe Jak Mitës u muar pëlqimi që të dilet në opinion me emrin Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës-PSHDK.

Po atë ditë në mbrëmje, po në të njëjtin vend u formua këshilli i parë nismëtar. Në atë takim u mor vendimi që kryetar i këtij subjekti politik të zgjedhet prof. Gjergj Rrapi si dhe u dakordua njëzëri që me datën 4 nëntor 1990 në Gjakovë të mbahet kuvendi themelues i PSHDK. Pikërisht kështu dhe ndodhi. Kuvendi ishte një tubim madhështor dhe u krahasua me një Bundestag gjerman. Por, përkundër marrëveshjes paraprake, në vend që të shpallet Gjergj Rrapi kryetar, kuvendi ndryshoi qëndrimin dhe për kryetar zgjodhi Lazër Krasniqin. Ky rast shënoi edhe fillimin e përplasjeve të brendshme të cilat vazhduan edhe më tej.

Vlen të theksohet se për një kohë të gjatë PSHDK ishte krahu i djathtë i partisë më të madhe në Kosove, i LDK me në krye Presidentin Historik të Kosovës Dr. Ibrahim Rugova. Në këtë parti u anëtarësuan dhe vepruan, disa më gjatë e disa më shkurt, edhe intelektualët e shquar si Zejnullah Gruda. Abdullah Kariagdiu, Gjergj Dedaj, Ramush Tahiri, Engjëll Sejday, Tahir Geci, Ymer Jakaj, Agron Zajmi, Nikë Gjeloshi, Muhamet Rugova, Ndue Nikaj, Zef Morina, Marjan Oroshi, Mihill Shala, Zef Shala (Smaq), Zef dhe Nikë Shala, Ton Marku, Marjan Demaj, etj. Poashtu në PSHDK kontribut kanë dhënë edhe veprimtarë të tjerë nga Podujeva, Gjilani Vitia, Ferizaji, Deçani, Malisheva, Prizreni e vende të tjera nga e tërë Kosova.

Duke pasur parasysh faktin se kjo parti u themelua në situatën e imponimit dhe të vendosjes së masave të jashtëzakonshme nga regjimi serbo-sllav, PSHDK megjithatë arriti të mbajë gjallë frymën lirisdashëse dhe demokratike si dhe që nga fillimi u rreshtua në anën e rezistencës gjithëpopullore në Kosovë. Ajo u formua si parti me parime dhe vlera të qytetërimit demokristian të Evropës. PSHDK gjeti mbështetjen edhe në vlerat e traditës, historisë, kulturës, letërsisë si dhe parimeve qytetëruese, shpirtërore dhe kombëtare shqiptare.



Në kohën e sukseseve më të mëdha të saj, kjo parti kishte rreth 120 000 anëtarë, 98 degë dhe 72 nëndegë në Kosovë, Kroaci, Slloveni, Gjermani, Zvicërr, Austri dhe SHBA.

Qëllimi i këtij artikulli nuk ishte që të shkruaj për personat e caktuar por për këtë parti, e cila pas përplasjeve të vazhdueshme, arriti që të shkapërderdhet aq shumë sa të mos jetë në gjendje të festojë ashtu siq duhej dhe pritej as 20 vjetorin e themelimit të saj.

Me këtë rast apeloj te të gjithë ata anëtarë dhe simpatizantë që kontribuan në themelimin e PSHDK, por që u larguan prej saj në mënyra dhe forma të ndryshme, të bashkojnë mendjen dhe zemrën që me 4 nëntor 2011 të bashkohen në një trup të vetëm dhe të bëjnë që të dëgjohet përsëri zëri, shpirti dhe kultura kristiane në të gjitha trojet shqiptare.



Intervistë me: ... politologen dhe këngëtares e mirënjohur nga Mali i Zi, Violeta Marniku

E nderuara znj. Marniku, posa i keni përfunduar studimet e shkencave politike, por jeni edhe një këngëtare me perspektivë. Cili do të ishte profesioni juaj i preferuar: politikologe apo këngëtare?

Muzika dhe arti vetë në jetë sjellin emocione që vetëm ata që veprojnë në këtë fushë mund t'i kuptojnë dhe përjetojnë. Megjithatë, një ritëm dhe një dinamikë e tillë mund të jenë të lodhshëm. Unë kam filluar të merrem me muzikë shumë e re, dhe mendoj se ka ardhur koha që të hulumtoj fushat tjera. Kjo nuk do të thotë se do ta braktis muzikën, mirëpo fokusi im po zgjerohet me përfundimin e studimeve.

Cilat ishin sukseset tuaja të para në lëmin e muzikës?

Në moshën trembëdhjetë vjeçare fillova të prezantohem në koncerte të kolegëve të mi dhe ky ishte hapi i parë në njohje me publikun shqiptar nga të gjitha trevat. Albumi im i parë doli një vit më vonë dhe suktesi me të cilin u prit më tregoi se isha në rrugë të drejtë.

Ju jeni shpërblyer edhe si studente e dalluar. Për cilin çmim bëhet fjalë?

Në këtë rast fjala ishte për një show televiziv ku të drejtë pjesëmarrjeje kishin studentët nga Mali i Zi. Emisioni kishte karakter garues dhe pjesëmarrësit ishin të detyruar të prezantojnë njohuritë e veta nga fushat shoqërore, ekonomike dhe historike nga aspekti i një lideri të ardhshëm potencial në frymën e vizionit për të ardhmen. Brenda një konkurrence të gjërë, ku vetëm 24 më të mirët patën mundësi të hyjnë në garat televizive, unë me votat e jurisë profesionale dhe të mbarë opinionit u shpalla fituese e ciklit.

Si e vlerësoni perspektivën e shqiptarëve në Mal të Zi?

Shqiptarët në Mal të Zi gjithnjë janë në tundim për zgjidhje nga një spektër i cili nga një herë nuk ofron asnjë zgjidhje optimale, të pa gatshëm dhe të pa guximshëm për të shpikur dhe për të luftuar për zgjidhje të reja dhe cilësore. Interesat personale e kanë ndarë një pakicë në pjesë mikroskopike, të paaftë për të marrë pjesë në procese të vendimmarrjes. Partitë e shumta politike janë vetëm skenografi për ndalimin e realizimit të interesave të një kombi. Jeta kulturore, stimulimi intelektual i të rinjve dhe çdo aspekt tjetër shoqëror zhvillohet ose nën patronazhin e institucioneve shtetërore, që nga ana e bashkatdhetarëve karakterizohet si tradhtarë, apo me mbështetje të diasporës, që e bën të jetë si e falur. Të dy opsionet krijojnë frustracion.

Sa ndikon harmonia familjare në sukseset në profesion?

Nuk mjafton të thuash se ndikon, jeta familjare është baza nga të cilat rrjedhë çdo sukses dhe është strehë ku mund të akumulohet forca për t'i duruar të gjitha kritikën dhe sulmet që vijnë nga bota e jashtme.

Cilat janë tiparet kryesore të muzikës shqipe në Mal të Zi?

Shqiptarët në Mal të Zi janë një treg i vogël për muzikë. Trendët muzikore tek ne vijnë me vonesë. Megjithatë, janë shumë këngëtarë të suksesshëm, shumica e tyre merren me muzikë popullore, por gjithnjë duhet ditur se trendët i formon kërkesa, në këtë rast është publiku ai i cili i dikton drejtimet e zhvillimit të mbarë estradës.

Ju performuat në një koncert madhështor në Vjenë për nder të festës së Krishtlindjeve, me 25 dhjetor 2010. Kjo ngjarje u organizua nga Misioni Katolik Shqiptar në Austri. Cilat janë përshtypjet tuaja nga qëndrimi disa-ditor në Vjenë?

Asnjëherë më parë nuk kam qenë në Vjenë. Takimi me këtë qytet në një periudhë kaq të veçantë siç është festa e Krishtlindjes ishte i papërshtueshëm. Nuk e paramendoja se Misioni Katolik Shqiptar në Austri është kaq aktiv, dhe do të ishte nderë që të kemi njerëz të tillë edhe më afër trevave shqiptare.

Cili është mendimi juaj për të rinjtë shqiptarë në Vjenë?

Më së miri mund të flasë për energjinë që ndamë gjatë kohës kur isha në skenë, kur shikoja atë gëzim dhe hare që mbizotëron në vallet e tyre. Duhet theksuar edhe faktin se në asnjë moment nuk jemi ballafaquar me asnjë problem, që tregon për dy gjëra: organizimin e mirë dhe cilësor, por edhe për nivelin e lartë të kulturës së të rinjve shqiptar.

Cilat janë planet tuaja të ardhshme në aspektin profesional?

E besoj se do të vazhdoj arsimimin në një nga fushat që më interesojnë. Gjithashtu, pres të angazhohem diku, në një institucion ku do të më jepet mundësia për të përfaqësuar më së miri interesat e popullit tim në shtetin ku jetojmë.

Cilat janë ambiciet tuaja si këngëtare?


E thashë edhe në fillim, emocionet që i sjellë arti dhe performanca publike janë të pazëvendësueshme. E besoj se do të vazhdoj të këndoja aq sa më lejon koha dhe sa vazhdojnë ftesat.

Intervistoi: Anita Marku

Fjala jonë

Roli i intelektualit në diasporë

Në 40 vitet e fundit shqiptarët migruan në numër të madh. Destinacioni i tyre ishte kryesisht Evropa Perëndimore. Në këtë proces dallohen tre faza: gjenerata e parë e „Gastarbeiter-ave" në vitet 1970-80 kur nga atdheu i tyre largoheshin kryesisht punëtorët e krahut, vitet 1990-ta që karakterizoheshin me shpënguljen e të përndjekurve politikë dhe ekonomikë, ndërsa pas vitit 2000 kryesisht vihen re bashkimet familjare, adoptimet, martesat e „përziera", quazi „azilkërkuesit" dhe studentët.



Interesi i përgjithshëm

Në situatën ku me qindra mijëra shqiptarë jetojnë dhe veprojnë larg vendlindjes ëshë nevojë imanente që intelektualët shqiptarë të marrin jo vetëm përgjegjësinë, por edhe obligimin që të udhëheqin proceset e integritimit së pari mbrenda-shqiptarë dhe më pas edhe ato me komunitetet vendëse. Në të njëjtën kohë ata duhet orientuar bashkëmbasit e tyre që në asnjë mënyrë të mos ju nënshtrohen presioneve të asimilimit. Pra, është më se e mundur që në të njëjtën kohë të jesh edhe shqiptar edhe evropian.

Interesi personal

Duke dashur që të mos gjeneralizojmë gjërat dhe duke respektuar përjashtimet dhe shembujt e mirë, në përgjithësi fitohet përshtypja se një pjesë e shqiptarëve nga një shoqëri kolektive në të cilën kanë jetuar për shumë vite, kanë ardhur në përfundim dhe shumë më

shpejt se sa është pritur dhe është dashur janë „individualizuar" dhe „personalizuar", deri në atë masë sa që turpërohen të identifikohen me vendin e orgjinës. Në këtë transformim të unit atyre nuk u intereson më se çfarë po ndodhë rreth tyre. Sidomos cilat janë hallet dhe vështirësitë e bashkëkombasve të tyre. Pjesë që veten e quan „elitë", e sidomos ata që janë në përfundim e sipër apo tashmë kanë përfunduar studimet në ndonjë nga univezitetet e kësaj hemisfere, kryesisht distancohen dhe qëndrojnë larg njerëzve të tyre. Ka dhe nga të tillë që sapo dëgjojnë fjalë në gjuhën shqipe kthejnë kokën prapa dhe largohen duke mos dashur të prezantohen se janë nga „rrënjë e njëjtë".

Mes të përgjithshmes dhe personale

Diaspora jonë duhet ta definojë se si dëshiron të organizohet në të ardhmen: në baza partiako-politike, civilo-shoqërore, institucionale, ekonomik-biznesore, në mënyrë grupore apo në stuhi individualiste. Definitivisht në këtë proces duhet marrë pjesë që të gjithë, kush më shumë e kush më pak. Udhëheqës dhe orientues të këtyre angazhimeve duhet të jenë intelektualët e vërtetë dhe me ndjenja kombëtare dhe jo „intelektualët" apo sharlatanët të cilët në emër të një „emancipimi univerzal" fshehin paaftësinë e tyre duke ikur nga çdo gjë që bashkon shqiptarët. Apelojmë që të mos lejojmë që të tjerët të bëjnë më shumë për ne sa na vetë.

P.S: Është për të ardhur keq kur ndodhë që një OJQ austriake („HelpKosova"), e cila ka dhënë një kontribut të madh për të rinjtë me aftësi të kufizuar në Rahovec, feston në Vjenë (qytet ky në të cilin mendohet se jetojnë rreth 20 000 shqiptarë) tre-vjetorin e themelimit, ndërsa në këtë manifestim marrin pjesë 3 kosovarë dhe 40 austriakë. Kush kënd duhet falënderuar këtu?

Fjala jonë

Kujt po i pengon „Dielli"?

Sipas disa të dhenave në Austri ka 22 shoqata shqiptare, 9 parti politike, 1 organizatë studentore, 2 misione fetare dhe një numër tjetër të grupimeve të grave, këngëtarëve, sportistëve dhe të ngjashme. Në këtë mozaik organizimesh „Dielli Demokristian" është e vetmja revistë periodike, e cila ka për qëllim të informojë dhe promovojë aktivitetet dhe organizimet që ndodhin në Austri në përgjithësi, dhe në Vjenë në veçanti. Por, duket se ka dhe të tillë të cilët po i „bezdisë" ky diell në gjuhën e tyre amtare. Kjo sidomos vërehet tek ata që do të duhej të ishin shtyllë e fuqishme

e kësaj reviste. Një numër i studentëve të kontaktuar për të kontribuar me shkrimet e tyre ende po hezitojnë që ta bëjnë këtë. Arsyet janë nga më të ndryshmet: mungesa e kohës, frika e identifikimit si anëtarë i një partie politike apo dhe parandjenja se do të „izoloheshin" nga „ajka" të cilës ata mendojnë se u përkasin. E para, për të shkruar një artikull përmbajtësor me një temë të njohur për autorin në një faqe tekst nuk do të duhej marrë më shumë se një orë kohë. Po ata studentë për pothuajse çdo provim në studimet e tyre detyrohen të shkruajnë nga 10-15 faqe punime seminarike në gjuhën gjermane apo angleze. Vështirësi kanë me gjuhën amtare!. Kjo është sa qesharake aq dhe tragjike. E dyta, në këtë revistë botojnë shqiptarë të besimeve dhe gjinive të ndryshme, dhe me pikëpamje të ndryshme (a)politike. Të jesh pjesë e „Diellit" asesi nuk do të thotë të jesh anëtarë i një grupimi të caktuar politik. Së fundi, të kontribosh për revistën e vetme në gjuhën shqipe në Austri duhet të kuptohet si nder dhe si privilegj. Si redaksi ju bejmë thirrje të gjithë atyre që ende nuk e kanë kuptuar misionin e kësaj reviste që ta respektojnë, çmojnë dhe ruajnë „Diellin" dhe rrezet me të cilat ai po provon të na ngrohë shpirtërat duke na folur shqip.

„Edhe pse shumë njerëz nuk e meritojnë dritën, prapë se prapë dielli lind çdo mëngjes" (fjalë e urtë latine)



Shkruan: Mhill Marku, student në shkallën e tretë-master në Prishtinë, në drejtimin e historisë

Rini-Ju Jeni Ardhmëria e Kombit

(vijon nga numri i kaluar: pjesa e dytë)

Rini e dashur, duhet të jemi të vetëdijshëm se aborti është krim. Edhe Mahatma Gandhi shprehet me këto fjalë „Sikurse më është e qartë drita e ditës, ashtu më është e qartë se aborti është një krim”. Për këtë arsye atyre që papjekurinë e të rinjëve tanë e përdorin me këto qëllime të këqija iu themi: -Është mëkat i pafalshëm para Zotit dhe Kombit që dikush të pasurohet duke i shkatërruar gjeneratat e reja, ardhmërinë tonë. Nuk është e lejueshme të ndërtohet lumturinë tëndë duke shkatërruar lumturinë e të tjerëve.

Por çka duhet të bëjmë që rinia jonë të jetë ardhmëria e vendit dhe kombit tonë? Të gjithë e dimë se më lehtë është të edukosh se sa të ri-edukosh. Prandaj t'i përvjelim krahët ne si intelektualë që tu ndihmojmë fatosave tanë në gjetjen e rrugës së vërtetë. Mos të lejojmë që ardhmërinë tonë ta helmojnë rruga dhe shoqëria e keqe. T'i drejtojmë ata kah idealet e shëndosha, kah ato vlera të cilat sot dhe nesër do t'i aftësojnë që ta udhëheqin popullin tonë në një rrugë të drejtë. „Një komb duhet të jetë i virtutshëm po të dojë të jetë i lirë” thotë Xh.Washington.

Rini e nderuar, mos harroni se populli ynë ka nevojë për ju. Sepse ju jeni kroi ku e shuajmë zjarrin e zemrës së shkumbuar ndër shekuj. Mos lejoni që azili të bëhet më i shtrejtë se nderi, familja dhe atdheu. Pra, ju-pjesa më vitale e Kombit, drita e qenies shqiptare, bërthama e identitetit tonë-mos e braktisni atdheun në këto momente kur atij më së tepërmi i nevojiteni. Mos e humbni ndjenjën e përgjegjësisë për të ardhmen, sepse

në fakt, vetë jeta është përgaditje e ardhmërisë. Duhet të vetëdijësohemi se në çfarë rrethanash të vështira jemi duke jetuar, dhe që të gjitha këto t'i gjykojmë duke u bazuar në të përditshmen tonë, sidomos lidhur me edukatën, arsimin dhe kulturën si parakushte për një jetë normale të secilit prej nesh.

Bëhuni ju ambasadorë apo misionarë të paqes, të dashurisë reciproke dhe të tolerancës. Mos harroni: - populli ynë sot më shumë se kurrë ka nevojë për intelektualë të mirëfilltë sepse ata janë pasuri kombëtare. Thesari më i madh për njeriun është dituria dhe nuk ka errësirë më të madhe se padituria. Nuk është turp të mos dish-turp është të mos dëshirosh të marrësh dituri. Populli ynë ka nevojë për njerëz të ditur, kulturuar dhe të ndershëm.

Sjellja e kulturuar, respekti ndaj mësimit, vetvetes dhe ndaj njëri-tjetrit duhet të jetë parim i secilit prej nesh. Pra, duhet arsimuar nëse duam që të formojmë një komb të mirë, sepse „Arsimi është shpirti i një kombi” thotë atdhetari ynë Hasan Prishtina. Duhet që të besojmë në njëri-tjetrin dhe të shpresojmë në njeri-tjetrin.

Shën Augustini thotë „Ama et fac quid vis” (Dashuro dhe vepra si të duash). Ju rini dashuroni, besoni dhe shpresoni! Por keni kujdes kënd dashuroni, kujt i besoni dhe në çka shpresoni që sot apo nesër të mos zhgënjeheni dhe dëshpërohëni. Rini ju jeni e ardhmja e vendit dhe kombit tonë!.

(fund)



Shkruan: Agron M. Camaj, jurist

Agron M. Camaj është jurist i diplomuar, kandidat për master, nga Malësia e Madhe, Mali i Zi. Për momentin punon pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Malit të Zi, në realizimin e projektit të Bashkimit Evropian - Bashkëpunimi ndërkuftar Shqipëri - Mali i Zi në kuadër të IPA fondeve. Ka punuar në Kuvendin e Malit të Zi si përfaqësuesi i UNDP/CDP-së, pranë Këshillit për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Integritim Evropian dhe në kabinetin e Kryebashkiakut të Podgoricës. Ka qenë pjesëmarrës aktiv në disa organizata ndërkombëtare dhe joqeveritare në Mal të Zi si dhe ka punuar për OSBE, KE dhe Fondin për të Drejtën Humanitare. Është interpretuesi gjyqësor për gjuhë shqipe. Punon dhe jeton në Podgoricë, Mali i Zi.

Politizimi i regjistrimit të popullsisë në Mal të Zi

(pjesa e parë)

Në teori dhe në praktikën ndërkombëtare, regjistrimi i popullsisë është vetëm dhe vetëm pjesë e statistikës, e cila kryesisht i mundëson shtetit që ta kryej në mënyrë më cilësore rolin e vetë themelor – përf forcimin e politikave të brendshme, sidomos në fusha të arsimit, shëndetësisë, punësimit dhe shërbimeve sociale. Por, për fat të keq, çdo ngjarje në Ballkanin tonë Perëndimor (edhe nëse ky epitaf nuk ka ndikuar në avancimin e vlerave dhe mentalitetit ballkanik) i cili ofron mundësi për përzjerje me nacionalizëm, menjëherë fiton statusin e çështjes historike. Ashtu në Mal të Zi, si dhe në të gjitha shtetet tjera të Ballkanit gati çdo vit kemi referendum, regjistrim ose zgjedhje, të cilat krijojnë fushata të zjarra gjatë të cilave dominojnë zërat e lartë të nacionalizmit, ksenofobisë dhe urrejtjes. Të gjitha këto vetëm për të mundësuar mbijetesën në skenën politike e një grupit të ngushtë me interesa të ulëta politike.

Regjistrimi i fundit i popullsisë së Malit të Zi u zhvillua në vitin 2003, vetëm dy muaj pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Beogradit, me të cilën Marrëveshje pushtetet serbe dhe malazeze dakorduan një moratorium, sipas të cilit Mali i Zi nuk do të shpallë referendumin për varësi. Në atmosferë të tillë, me një fushatë të rreptë nga partitë serbe në Mal të Zi u zhvillua regjistrimi i popullsisë i vitit 2003, i cili solli disa rezultate pothuajse të çuditshme. Malazet në Malin e Zi pas këtij regjistrimi nuk ishin më populli shumicë, duke ju “falënderuar” faktit se numri i serbëve në Mal të Zi, sipas këtij regjistrimi, u ngrit nga viti 1991 (kur ishte 9,15%) për më se 20% (31,99% në vitin 2003). Ky relacion erdhi si pasojë e dualizmit të mirënjohur të identitetit malazet dhe tregoi se shumica e malazetëve edhe se në fazën e etatizmit të shtetit të vetë nuk patën kryer akoma çështjen më të rëndësishme – çështjen e identitetit. Sipas regjistrimit të 2003, numri i shqiptarëve në Mal të Zi është zvogëluar nga 7,6% të vitit 1991, në 5,03%. Ky fakt nuk ka të bëjë me zvogëlimin e numrit të popullsisë shqiptare, por erdhi si pasojë e ngritjes së numrit të popullsisë së Malit të Zi, për shkak se shumë refugjatë lufte, kryesisht nga Bosnja dhe Hercegovina dhe Kroacia, të cilët u strehuan në Malin e Zi gjatë luftërave të viteve të nëntëdhjeta, fituan nënshpëtimin malazet. Numri i personave që i takojnë besimit katolik në Mal të Zi, sipas regjistrimit të vitit 2003, ishte 3,54%. Shumica e besimtarëve katolik në Mal të Zi i takojnë kombësisë kroate (kryesisht të banuar në qytete të Grykës së Kotorit), shqiptare (të banuar kryesisht në Malësi të Madhe afër Podgoricës dhe në Ulqin) dhe

pjesa e vogël e malazetëve, kryesisht nga Tivari dhe rrethina, ku gjendet dhe selia e argjipeskvisë.

Përgatitjet për regjistrimin e parë të popullsisë në Mal të Zi të pavarur (Mali i Zi me referendum u shkëput nga federata shtetërore me Serbi, më datën 21 maj 2006) këtyre ditëve po i pasqyrojnë problemet kryesore të ndërtimit të shtetit qytetar. Nacionalizmi, në manifestimin e vetë negativ, si fuqia më e fortë dhe më ekspansive e rajonit tonë, edhe kësaj radhe tregon superioritetin e vetë ndaj të gjitha formave liberale dhe universale të formimit të autonomive individuale dhe ndaj konstitucionalizmit të pushtetit politik, ndaj atyre formave, pra, të cilat Evropa i ka përfunduar me sukses gjatë revolucioneve të vitit 1848. Në Mal të Zi këtyre ditëve vazhdojnë fushatat perfide të udhëhequra nga gati të gjitha komunitetet kombëtare. Duke konsideruar egërsinë e fushatës nacionaliste serbe, të cilët mundohen ta

mbajnë numrin sa më të lartë të serbeve në Mal të Zi, pa tjetër rikujtohem se përdoret e njëjta retorikë si para disa viteve: fushata e mohimit të identitetit malazet (kombësia, gjuha dhe kisha malazeze) para këtij regjistrimi është vetëm hapi logjik i cili nuk dallon shumë nga fushatat të cilat janë ushtruar në Kroaci, në Bosnjë dhe në Kosovë gjatë viteve të nëntëdhjeta. Me atë që kësaj radhe atmosfera gjithëpërfshirëse e procesit të integritimit në Bashkimin Evropian i parandalon skenarët shkatërrues luftarakë të cilët janë ushtruar. Pyetja kryesore është: a janë ata qytetarë, të cilët në çdo moment posedojnë identitetin rezervë, identifikimin rezervë kombëtar dhe shtetëror, perspektiva e vërtetë e shteti i cili pretendon që të afirmohet edhe jashtë Ballkanit dhe a nevojitet për parimin e shtetit qytetar të proklamuar me Kushtetutë dhe njëlloj të patriotizmit kushtetues i cili mbështet në paradigme të besnikërisë rendit kushtetues dhe qytetar? Sepse, thirrjet që lëshohen këtyre ditëve për numërim të ndryshme, edhe nëse mirë të kamufluara, nuk kontribuojnë zhvillimit të vetëdijes mbi dallime, por as integritimit të komuniteteve të llojllojshme shoqërore të cilat bashkekzistojnë në një shtet multinacional siç është Mali i Zi. Për fat të keq, politizimi dhe mobilizimi nacionalist i regjistrimit të popullsisë i një shteti të vogël të Ballkanit i cili ka vetëm 620 000 banorë paraqet një provë të vrazhdë të realitetit politik e cila pa dyshim provon se fundi i historisë të cilin e ka parashikuar Francis Fukujama me universalizimin e demokracisë liberale, kur bëhet fjala për Ballkanin, do të presin edhe shumë kohë.

amcamaj@t-com.me

(vijon në numrin e ardhshëm)

Faqja historike

Shkruan: Lulzim Bazhdaraj

Famullia e Gjakovës

Gjatë shekujve kjo famulli ka përjetuar shumë maltretime dhe keqtrajttime nga pushtuesit otomanë – sidomos pas disfatës së tyre në Luftën e Vjenës (1683-1689). Për disfata të veta turqit u hakmerreshin të krishterëve brenda Perandorisë Otomane, kështu që një pjesë e të krishterëve u shpërngul kah Austro-Hungaria, një pjesë tjetër u islamizua, e një pjesë e madhe u laramanizua. Në kushte të tilla famullia e Gjakovës hyri në shekullin XVIII. Famullinë e Gjakovës në këtë kohë e vizitojnë shumë ipeshkvij të Kishës Katolike. Disa prej tyre si meshtarë edhe kanë shërbyer këtë famulli. Prej relacioneve të tyre, dërguara në Romë, pasqyrohet jeta e kësaj famullie para 200 vjetëve kur Gjakova ishte pjesë e Ipeshkvisë Shkup-Prizren.

Ipeshkvi i parë i shekullit XVIII në këtë ipeshkvi ishte **Mons. Pjetër Karagiqi**, i lindur me 1648 në Novo Bërdë, ish student i Kolegjit Ilirik në Loreto, emëruar ipeshkëv i Shkupit nga papa Klementi XI, më 1698. Gjatë kohës sa ishte ai ipeshkëv, u mbajt **Kuvendi Kombëtar i Arbërit, më 1703**, në të cilin mori pjesë edhe ai personalisht. Karagiqi vdiq në Zym, në qershor 1727. Në letrat e tija mbi vizitat kanonike Kryeipeshkvisë së Shkupit, më 1706 dhe 1710, thuhet se famullinë e Gjakovës me rrethinë e drejtojnë dy misionarë apostolikë: françeskanët e reformuar, **Atë Zefi nga Golizato** dhe **Atë Domeniko Veneciani**, si edhe një frat laik, me profesion mjek. Ata banonin në Zogaj (në Hasin e Shqipërisë). Kishë në Gjakovë në atë kohë nuk kishte, e mesha thuhej në kapelën e shtëpisë së fretërve në Zogaj, si edhe nëpër shtëpitë familjare të besimtarëve. Numri i besimtarëve ishte 2.100

më 1706, kurse 2.300 më 1710. Më 1715. turqit i dëbojnë këta misionarë, me arsyetim se ishin të huaj (italianë). Arsyetja e vërtetë ishte aktiviteti i tyre i suksesshëm në këtë zonë, ku fretërit vepronin që nga viti 1638. Më 1719 Mons. Karagiqi përmend si famullitar në Gjakovë **don Gjon Gjonin**, lindur në Gjakovë. Në Gjakovë në atë kohë jetonin 800 besimtarë katolikë. Famullitari i ri kishte pagëzuar 150 fëmijë.

Në relacionin e vitit 1722, ipeshkvi thotë se në Gjakovë dikur ishte kisha e Shën Pjetrit, por është rrënuar prej turqve, kurse tani i shihen vetëm themelet. Me gurët e kishës turqit kishin ndërtuar shtëpitë dhe dyqanet e veta në qytet. Pas Mons. Pjetër Karagiqit kryeipeshkëv i Shkupit u bë **Mons. Mike Suma**, lindur më 1695. në Sapë (Zadrimë të Shqipërisë). Studimet i kreu në Kolegjin e Kongregatës de Propaganda Fide në Fermë. Pas vdekjes së Karagiqit e drejtoi ipeshkvinë më së pari si Vikar Kapitular, e prej 1728 si kryeipeshkëv i Shkupit. Mons. Mikel Suma, pas vizitës kanonike më 1729, shkruan se Gjakovën e shërben **don Gjon Gjoni**, me ndihmësin e vet, **don Anton Teodori**. Ata kujdesen për 16 shtëpi me 70 anëtarë besimtarësh në Gjakovë, ku ipeshkvi krezmoi 6 djem dhe 6 vajza, si edhe për 13 shtëpi me 180 besimtarë në Zogaj, ku u krezmuan 25 djem dhe 30 vajza. Krejt famullia kishte 1.200 besimtarë të krishterë. Në vitin 1735 Mons. Suma lajmëron për zhvillimin e famullisë, duke përmendur në Gjakovë 25 shtëpi me 126 anëtarë, në Zogaj 14 shtëpi me 218 anëtarë, në Rodagostë 20 shtëpi me 200 anëtarë, në Rust 13 shtëpi me 205 anëtarë, në Krastrosinë 13 shtëpi me 180 anëtarë, në Brekoc 5 shtëpi me 47 anëtarë dhe në Dujakë 6 shtëpi me 90 besimtarë të krishterë. Përveç këtyre famullia e Gjakovës kishte edhe 1.000 besimtarë tjerë të shpërndarë në grupe më të vogla nëpër fshatra tjerë, që i shërbenin **don Gjon Nikollë Kazazi**, vikari gjeneral, dhe **don Anton Teodori**, ndihmësi i tij.

Pas Mons. Sumës kryeipeshkëv i Shkupit u bë **Mons. Gjon Nikollë Kazazi**, lindur me 1 janar 1702 në Gjakovë. Studimet i kreu në kolegjin Ilirik të Shën Pjetrit e Palit në Fermë, ku fitoi titullin e doktorit të filozofisë dhe të teologjisë. Ai që prej vitit 1735 ishte famullitar në Gjakovë. Më 12 maj 1743 u emërua, kurse më 29 shtator u shugurua kryeipeshkëv i Shkupit. Ipeshkvinë e drejtoi deri më 1752. Më 1750 Gjon Nikollë Kazazi shkruan se në Gjakovë ekziston vetëm shtëpia e famullitarit, kurse kisha e Shën Pjetrit është rrënuar. Rrënuesit i ka ndëshkuar Zoti. (Nuk thuhet në çfarë mënyre.). Mons. Tomë Tomićiqi më 1756. e përmend si famullitar të Gjakovës **don Zef Berishën** nga Gjakova.

Mons. Matej Mazrreku nga Janjeva, pasardhës i Mons. Gjon Nikollë Kazazit, shkruan se gjatë vizitës së tij më 1760 gjithkund e kishin përcjellë besimtarët, për ta siguruar prej turqve. Strehohet te Gjon Krasniqi, mbrojtësi i të krishterëve, besimtar me ndikim të madh në popull. Famullitar i Gjakovës në atë kohë ishte **don Zef Berisha**, nga Gjakova, i cili jetonte në shtëpinë e prindërve të vet. Aty kremtonte edhe meshën dhe aty shërbente popullin. Me ndihmën e kryeipeshkëvit dhe me kontribut të besimtarëve bashkuan 200 talira dhe në vitin 1764 blenë një shtëpi të madhe për kishë dhe për banesë të famullitarit. Me 1764 ipeshkvi e vizitoi Gjakovën, por fshehtazi. E nuk vizitoi disa fshatra katolike – megjithëse ata e dëshironin vizitën e tij, që mos t'u japë shkas turqve për arrestime dhe keqtrajttime tjera. Në kushte të ngjashme ka jetuar edhe pasardhësi i don Zefit, don Ndre Gjon Krasniqi, po ashtu bir i Gjakovës. Gjendja e tillë vazhdoi gjatë krejt kohës – jo vetëm deri në fund të shekullit XVIII, por edhe në gjysmën e parë të shekullit XIX – deri te kthimi i laramanëve, më 8 shtator 1845 dhe tek ripërtëritja e famullisë, në vitin 1851.



Intervistë me: ... Halil Jasharin, kryetarin e komisionit të garave dhe arkatar i Ligës së Shqiptarëve në Futboll të vogël në Austri

I nderuari z. Jashari, a mund të na përshkruani një histori të shkurtër të krijimit të ligës së shqiptarëve në futboll të vogël në Austri?

Në fillim dua që të ju përsëris dhe të ju falënderoj për interesimin tuaj për të ndarë edhe një hapësirë në gazetën tuaj për Ligën Shqiptare të Futbollit të vogël në Austri (LSHFA). Liga tani ka mbushur një vit pune duke funksionuar si ligë me të gjitha strukturat e saj. Interesimi i kamotshëm i shumë shqiptarëve që punojnë dhe veprojnë në Austri ishte i madh që edhe ne këtu të gjejmë veten më të organizuar, dhe njëherit të kalojmë prej periudhës kur çdo vit organizonim turne të ndryshme në një sistem me të avancuar, i cili na afron shumë lehtësira dhe kënaqësi të veçanta sportive.

Nga lindi ideja për krijimin e një lige të tillë dhe kush ishte iniciatorët e parë?

Për themelimin e ligës rol shumë të rëndësishëm kanë luajtur shoqatat e ndryshme që veprojnë për një periudhë të gjatë, mbi 20 vite, këtu në Austri. Kështu që me propozimin e disa aktivistëve që kanë vepruar nëpër këto shoqata lindi dhe ideja dhe ajo u përkrah nga shumë të tjerë. Në shkurt të 2010 definitivisht u shënuar fillimi dhe funksionimi LSHFA. Si iniciator të parë mund të themi se ishin Qani Sulejmani, Halil Jashari, Ridvan Limani, Mexhid Beslimi si dhe shumë të tjerë që qysh në start na përkrahën fuqishëm.

Cili ishte qëllimi i krijimit të një lige shqiptare në futboll të vogël dhe cilat janë gjasat reale që të formohet një klub shqiptar në futboll të madh në një të ardhme të afërt?

Qëllimi është shumë i qartë dhe i lehtë për ta identifikuar -ne mendojmë se rinia shqiptare meriton një kujdes të tillë. Duke u futur në këtë lëmi, pra duke u marrë me sport, kjo nënkupton kulturë, shoqërim, zhvillim fizik, lidhje shumë të ngushta shoqërore, etj. Për krijim e një klubi në futboll të madh besoj se shpejt do të kuptohet rëndësia e saj. Me siguri se me shumë dëshirë do të punojmë edhe në atë drejtim.

Sa jeni të kënaqur me rezultatet e deritanishme?

Të jemi të sqertë, askush nga ne nuk ka pritur kaq rezultate pozitive, ngase ishte një barrë shumë e madhe. Por që kemi këto rezultate të mira duhet falënderuar rininë e mrekullueshme e cila dha maksimumin duke respektuar të gjitha rregullat e ligës për të cilat ne ishim përkujdesur që ato t'i përshtaten rrethanave.

Cilat janë kriteret për regjistrim dhe sa klube numëron liga për sezonin e sivjetshëm?

Si kriteret të dorës së parë mund të themi se çdo i interesuar duhet që të pranojë statutin e ligës, si dhe t'i përmbahet rregullave të cilat i kemi vendosur. Për vitin 2011 LSHFA numëron 14 klube.

Cili është sistemi i garave në këtë ligë dhe kur dhe ku do të mbahet turneu dhe ndeshja e parë për këtë vit?

Ne kemi zgjedhur një sistem i cili i përshtatet edhe ligës e edhe ekipeve, por më me rëndësi është që nëpërmjet këtij sistemi të tregojmë kualitet dhe disiplinë. Çdo klub brenda vitit 2011 është i obliguar që një herë të jetë nikoqir i ekipeve tjera dhe të organizojë një raund takimesh, ku do të ndeshen të gjitha ekipet nga dy herë: -si nikoqir, gjegjësisht mysafirë. Sipas rregullave që janë vendosur raundi i parë do të fillojë me 17 prill 2011 në Vjenë.

Cilat janë strukturat udhëheqëse të kësaj lige?

LSHFA ka edhe organet e veta si: kryesinë prej 6 anëtarëve, komisionin e garave (3 anëtarë) komisioni disiplinor (po ashtu 3 anëtarë) si dhe udhëheqësin e gjyqtarëve/referëve.

Sa keni gjetur përkrahje nga sponsorët, komuniteti shqiptar në Austri dhe dashamirët e sportit?

Duhet falënderuar të gjithë ata të cilët ndihmuan dhe përkrahën ligën qysh prej fillimit të ekzistimit të saj. Jemi të bindur se këtu ka edhe shumë më tepër hapësirë: Mendojmë se me kohë do të ndryshojnë shumë gjëra, dhe atë pozitivisht. Në këtë kontekst, ne kemi planifikuar edhe një takim me afaristë shqiptarë për ta çuar ligën në suksese edhe më të mëdha.

Cilat janë planet e ligës në të ardhmen?

Në kuadër të ligës kemi edhe përfaqësuesen e LSHFA. Vitin e kaluar kemi zhvilluar dy ndeshje miqësore me klubet Austriake Gänsemorf dhe Kronnberg. Në të dyja këto ndeshje arritëm fitore. Kjo na jep të drejtë që edhe brenda këtij viti të përsërisim rezultatet e mira. Mendojmë se rritja e cilësisë dhe kualiteti mbetet prioritet i parë për udhëheqësin e ligës. Që me datën 13 mars 2011 do të mbahet një seminar ku do të ndahen edhe licencat e trajnerit.



Cili do të ishte mesazhi juaj për të rinjtë shqiptarë në Austri?

Unë kam një mesazh shumë të thjeshtë për gjithë rininë shqiptare, duke apeluar së pari te të gjithë prindërit që të japin maksimumin. Duke ndihmuar sportin do t'i ndihmojnë edhe fëmijëve të tyre, pasi që edhe një nga qëllimet e krijimit të saj ishte largimi i të rinjve nga rrugët të gabuara dhe futja e tyre në një sistem që do të thotë edukatë, respekt ndaj tjetrit dhe vet-disiplinë. Të gjitha këto janë veti shumë të vlefshme për jetën e një individit. Dua të them se sporti është mjeti më i mirë komunikues me të tjerët. Për fund, në emrin tim dhe të LSHFA i përsëris dhe të gjithë shqiptarët kudo që janë dhe në veçanti sportdashësit tanë.

Intervistoi: Mark Marku

Info blic:

Në Vjenë mbahet koncerti tradicional për nder të Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri:

Për të tretin vit me radhë, me 25 dhjetor 2010, nën organizimin e Misionit Katolik Shqiptar në Austri (MKSHA) u mbajt koncerti familjar me këngë e valle popullore. Kësaj radhe për atmosferën e duhur, duke sjellur tek publiku melosin e pastër shqiptar, u përkujdes këngëtarja e mirënjohur nga Mali i Zi, Violeta Marniku. Me disa këngë u paraqitën edhe këngëtarët me perspektivë Nikolle Gjini dhe Mark Marku, ndërsa për orkestimin u kujdes muzikanti i njohur Zakir Popaj.

Regjistrimi i klubit të MKSHA në Ligën Shqiptare të Futbollit të vogël në Austri:

Me 16 shkurt 2011, me iniciativën e disa aktivistëve të Misionit dhe nën mbështetjen e sekretarit të ligës, Januz Saliuka u bë e mundur që në mesin e 14 ekipeve shqiptare që do të garojnë këtë vit për titullin e më të mirit në futboll të vogël, të regjistrohet edhe ekipi i MKSHA. Turneu u parë fillon në muajin mars ndërsa sezoni sportiv përfundon në shtator, kur pritet të shpallet dhe kampioni i ligës, trajneri, gjyqtari, lojtari dhe golashënuesi më i mirë, ekpi më i dicitpluar, etj.

Manifestime të ndryshme për nder të tre-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës:

Edhe këtë vit shoqata të ndryshme shqiptare kishin përgaditur programe të larmishme festive. Vlen të përmenden shoqatat „17 shkurti” dhe „12 qershori” nga qyteti Baden, „2 korriku” nga Wienerneustadt, „Kosova” nga Linz-i, Shoqata e Mësuesve dhe Prindërve Shqiptarë në Austri „Vale” me seli në Vjenë, etj. Vlen të theksohet se në keto manifestime morën pjesë një numër i madh i bashkatdhetarëve tanë, përfaqësues të Ambasadave të Kosovës dhe Shqipërisë në Vjenë, si dhe përfaqësues nga institucione të ndryshme austriake. Koncertet zakonisht filluan me intonimet e himnit kombëtar shqiptar dhe atij shtetëror të Kosovës, ndërsa u pasuan me pika te veçanta dhe të pasura kulturo-artistike. Disa nga këto manifestime u përcollën edhe nga një ekip i Radio Televizionit të Kosovës.



Formohet keshilli inciues për themelimin e degës së PSHDK në Wienerneustadt

Me 27 shkurt 2011 në Wr. Neustadt (rreth 60 km larg nga Vjena), me pjesëmarrjen e më se 20 aktivistëve dhe simpatizantëve të saj, është mbajtur takimi për zgjedhjen e këshillit organizativ për formimin e degës së Partisë Shqiptare Demokristiane të Kosovës (PSHDK) për këtë qytet. Pjesëmarrësit në këtë takim unanimisht vendosën që këshilli organizativ të ketë përbërje:

1. Mark Gjuraj, kryesues i këshillit
2. Gjokë Duhani
3. Marjan Balaj
4. Pren Pjetri
5. Marjan Kola
6. Viktor Martini
7. Gjevalin Nokaj

Takimi i radhës do të mbahet me 20 mars 2011, ku pritet që të caktohet edhe data e mbajtjes së kuvendit themelues të degës së PSHDK për Wr. Neustadt.

Këndi kulturor:

Kanë thënë për jetën:

- Hapi i parë për të përjashtuar gjërat e padëshiruara nga jeta është kjo: **Vendos çfarë do.** (Ben Stein)
- Jeta është diçka që ndodh kur s'të zë gjumi. (Fran Lebowitz)
- Jeta është diçka që të gjithë duhet ta provojnë së paku njëherë. (Henry J. Tillman)
- Jeta është e këndshme. Vdekja është e qetë. Tranzicioni është pak i mundimshëm. (Isaac Asimov)
- Jeta është ajo që të ndodhë përderisa je i zënë duke bërë plane tjera. (John Lennon)
- Jetesën e bëjmë nga ato që marrim, jetën e bëjmë nga ato që japim. (Winston Churchill)

Kuriozitete:

- Që të arrijë dikush të shohë ylberin, duhet më parë t'i kthejë shpinën diellit
- Eskimezët përdorin frigoriferë për të mbrojtur ushqimin e tyre nga ngrica
- Majdanozi është erëza që përdoret më shumë në të gjithë botën
- Orkestra kombëtare e Monakos është më e madhe në numër se sa ushtria e tij
- Gjysma e popullsisë së rruzullit tokësor ka parë filmin e James Bond
- Fjala „Himalaja” do të thotë „Shtëpia e Dëborës”
- Tingulli që bëjnë ujëvarat e Victoria dëgjohen në një distancë prej 64 km

Nga gurra e folklorit tonë:

DON NIKOLLË KAÇORRIT (rapsodi)

Po s'e shkrove sot një kangë,
penda ime, mos shkrofsh kurrë.
Po them kangë, për t' mos thanë gjamë,
don Nikollës, burrit mbi burrë,

E me u këndue n'tel t'çiftelisë
An' e kand ku ka shqiptarë,
Namë të madh i la Shqipnisë,
Nuk harrohet ky pishtar.

Ka dhanë provë ku lypi puna
ku ma shumë iu desht Shqipnisë,
në daç n' hartim të alfabetit,
në daç në shpallje t' Pavarësisë.

Jo po mbreti e diktatori
Historinë ndryshuen, qe besa,
Kand e vranë, kand e larguen,
E pat mb'lue do kohë harresa.

Prej shumë djemve, nanë Shqipni,
që s'ua din vorrin ku e kanë,
një prej tyne t' ktheva sot,
ta mbajsh n' gji për jetë e mot.

Xhenc Bezhi
shkurt 2011